





# **MODULI**

## **TRAJNIM PËR VEPRIMIN ME VIKTIMAT E TREGTISË ME NJERËZ**

Jasmina D. Rajkovska, Marija Todorovska

**osbe** Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Misioni në Shkup**

Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup.



# Përmbajtja

LISTA E AKRONIMEVE.....	5
<b>MODULI - TRAJNIM PËR VEPRIMIN ME VIKTIMAT E TREGTISË ME NJERËZ.....</b>	<b>6</b>
<b>SESIONI I. ÇFARË ËSHTË TREGTIA ME NJERËZ?.....</b>	<b>7</b>
CILAT JANË FORMAT E EKSPLOATIMIT?.....	10
PËRKUFIZIMI I TREGTISË ME NJERËZ.....	11
KORNIZA LIGJORE NË MAQEDONINË E VERIUT.....	12
MOS DËNIMI I VIKTIMAVE TË TREGTISË.....	14
PROCEDURA PENALE.....	15
DREJTËSIA PËR FËMIJËT.....	16
MBROJTJA E DËSHMITARËVE.....	18
MBROJTJA E TË HUAJVE QË JANË VIKTIMË E TREGTISË ME NJERËZ.....	19
NDIHMA DHE PËRKRAHJA E VIKTIMAVE.....	21
ELEMENTET E TREGTISË ME NJERËZ.....	23
KONTRABANDA ME IMIGRANTË V.S.V TREGTIA ME NJERËZ.....	25
<b>SESIONI II. IDENTIFIKIMI I VIKTIMAVE TË TREGTISË.....</b>	<b>27</b>
PËRSE KA RËNDËSI IDENTIFIKIMI I VIKTIMAVE?.....	29
SFIDAT E IDENTIFIKIMIT TË VIKTIMËS SË TREGTISË ME NJERËZ.....	31
PROCESI I IDENTIFIKIMIT TË VIKTIMAVE.....	32
VLERËSIMI I INDIKATORËVE.....	34
INTERVISTA.....	37
<b>SESIONI III. MBROJTJA E VIKTIMAVE TË TREGTISË ME NJERËZ.....</b>	<b>40</b>
PASOJAT FIZIKE DHE PSIKOLOGJIKE NDAJ VIKTIMAVE.....	41
SPECIFIKAT PËR FËMIJËT.....	41
PASOJAT DHE NEVOJAT FIZIKE.....	42
PASOJAT DHE NEVOJAT PSIKOLOGJIKE.....	43
STRESI POST-TRAUMATIK (PTSD) (SJELLJA DHE NEVOJAT).....	44
SHENJAT DHE SIMPTOMAT E PTSD.....	45
SIGURIMI I NDIHMËS DHE PËRKRAHJES PËR VIKTIMAT E TREGTISË ME NJERËZ.....	47
AKOMODIMI I SIGURT.....	47
INFORMIMI I VIKTIMAVE.....	48
PËLQIMI PËR PRANIMIN E PROGRAMIT PËR NDIHMË DHE PËRKRAHJE.....	48
VLERËSIMI I NEVOJAVE.....	49
PLANI INDIVIDUAL I TRAJTIMIT.....	49
ADAPTIMI DHE STABILIZIMI.....	50
SHËRBIMET PËR VIKTIMAT E TREGTISË ME NJERËZ.....	52
NDIHMA MJEKËSORE.....	52
NDIHMA DHE KËSHILLIMI I SPECIALIZUAR PSIKO-SOCIAL.....	52
KËSHILLIMI JURIDIK.....	53
ARSIMIMI DHE KUALIFIKIMET PROFESIONALE SHITESË.....	54
INKUADRIMI I FAMILJES/BASHKIMIT TË SËRISHËM.....	56

<b>SESIONI IV. RISOCIALIZIMI DHE RIINTEGRIMI</b> .....	<b>57</b>
PËRGATITJE PËR RISOCIALIZIM DHE RIINTEGRIM.....	60
UDHËZIMET PËR VAZHDIMIN E RIINTEGRIMIT.....	61
PLANI I RISOCIALIZIMIT DHE RIINTEGRIMIT.....	62
KTHIMI I SIGURT.....	64
VLERËSIMI I RREZIQEVE DHE MUNDËSIVE PËR INKUADRIM SOCIAL.....	66
ZHVILLIMI I PLANIT PËR MENAXHIMIN E RREZIQEVE.....	67
<b>SESIONI V. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET DHE ORGANIZATAT</b> .....	<b>69</b>
KOMISIONI NACIONAL.....	71
MEKANIZMI NACIONAL PËR UDHËZIMIN E VIKTIMAVE TË TREGTISË ME NJERËZ (MNU).....	72
QENDRAT PËR PUNË SOCIALE.....	72
EKIPET MOBILE.....	72
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME.....	73
POLICIA.....	73
NJËSIA NACIONALE PËR LUFTË KUNDËR TREGTISË ME NJERËZ DHE MIGRIMEVE ILEGALE (NJLTNJMI).....	73
PROKURORIA PUBLIKE DHE GJYKATA.....	73
INSTITUCIONET E MBROJTJES SOCIALE DHE QËNDRIMIT TË PËRKOHSHËM –.....	74
QENDRA PËR VIKTIMAT E TREGTISË ME NJERËZ DHE VIKTIMAT E DHUNËS SEKSUALE.....	74
QENDRA E STREHIMIT PËR TË HUAJT.....	74
MINISTRIA E ÆRSIMIT DHE E SHKENCËS.....	75
INSPEKTORATI I PUNËS.....	75
ORGANIZATAT JOQEVERITARE.....	75
ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE.....	75
PROFESIONISTË DHE BASHKËPUNËTORË TË TJERË.....	75
RAPORTUESI NACIONAL PËR TREGTINË ME NJERËZ.....	76
<b>ANEKSI 1</b> .....	<b>77</b>
<b>ANEKSI 2</b> .....	<b>79</b>

## Lista e akronimeve

<b>PKD</b>	Përfaqësitë diplomatike konsullore
<b>NJTNJTE</b>	Njësia për tregti me njerëz dhe trafikim të migrantëve
<b>SHV</b>	Shoqatat e qytetarëve
<b>LPP</b>	Ligji për procedurë penale
<b>ONE</b>	Organizata Ndërkombëtare e Emigracionit
<b>QNPS</b>	Qendra ndërkomunale për punë sociale
<b>KP</b>	Kodi penal
<b>MPPS</b>	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
<b>MPB</b>	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>MSH</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>MASH</b>	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
<b>MPJ</b>	Ministria e Punëve të Jashtme
<b>NJLTNJMI</b>	Njësia nacionale për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe migrimeve ilegale
<b>MNU</b>	Mekanizëm nacional i udhëzimit
<b>OKB</b>	Organizatës së Kombeve të Bashkuara
<b>PTHPNKOK</b>	Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit
<b>ShSPT</b>	Shkatërimi nga stresi pos-traumatik
<b>ÇSPT</b>	Çrregullimi nga stresi pos-traumatik
<b>QPH</b>	Qendra e strehimit për të huajt
<b>RMV</b>	Republikës së Maqedonisë së Veriut
<b>SPB</b>	Sektor i Punëve të Brendshme
<b>PSO</b>	Procedura standarde operative
<b>TNJ</b>	Tregtisë me njerëz
<b>MTU</b>	Mekanizmi Transnacional për Udhëzim
<b>QPS</b>	Qendra për punë sociale
<b>QV</b>	Qendra për personat viktime të tregtisë me njerëz

## Moduli- Trajnim për veprimin me viktimat e tregtisë me njerëz

**M**oduli është dizajnuar për t'u ndihmuar personave profesionalë në rritjen e njohurive të tyre për tregtinë me njerëz, në aspekt të identifikimit, mbrojtjes dhe qasjes profesionale të viktimave të tregtisë me njerëz. Moduli është i organizuar në V sesione ku shqyrtohen temat si: Njohuri themelore për tregtinë me njerëz, kornizën ligjore, procesin e identifikimit dhe indikatorët për identifikim, procesi i mbrojtjes, vlerësimi i nevojave, udhëzimet për praktikat më të mira të kujdesit për viktimat e tregtisë me njerëz, risocializimin dhe riintegrimin, si dhe bashkëpunimin e ndërsjellë të institucioneve dhe organizatave për ndihmë dhe përkrahje të koordinuar.



# SESIONI I.

## ÇFARË ËSHTË TREGTIA ME NJERËZ?

**T**regtia me njerëz është krim i pranuar në nivel ndërkombëtar. Në tërë botën, burrat, gratë dhe fëmijët sillen në situata të eksploatimit të rëndë nga persona të tjerë me qëllim të përfitimit. Kjo mund të përfshijë eksploatimin seksual, punën e detyrueshme, robërinë ose praktika të ngjashme dhe/ose nxjerrjen e dhunshme të organeve. Eksploatimi i këtillë ndodh posaçërisht në sektorë të pasigurt me të drejta të dobëta të punëtorëve. Si shembuj janë industria seksuale, ndërtimtaria dhe bujqësia, por edhe puna në shtëpi. Njerëzit gjithashtu tregtojnë me njerëz për qëllime të veprave ilegale si lypja, korrrjet, tregtia me drogë dhe sajber kriminaliteti.

Duke i detyruar ose keqpërdorur fuqinë ose shfrytëzimin e cenueshmërisë së tyre, personat detyrohen të punojnë ose të ofrojnë shërbime. Ata përjetojnë një sërë shkeljesh të të drejtave, duke filluar nga kufizimi i lëvizjes deri te dhuna dhe keqpërdorimet e rënda. Tregtia jo çdoherë përfshin kalimin e kufijve. Mund të paraqitet në një vend, respektivisht si tregti e brendshme me njerëz.

Në nivel global, zakonisht si caqe për rekrutim janë personat që janë më të cenueshëm, ndërsa shkalla e cenueshmërisë fatkeqësisht edhe më tepër është rritur me pandeminë e KOVID-19. Fëmijët që jetojnë në varfëri të skajshme dhe si imigrantë janë kategori të njerëzve me gjasa më të mëdha për rekrutimin e viktimave të tregtisë.

Në aspekt të atyre që merren me tregtinë me njerëz, në nivel global grupet e organizuara kriminale tregtojnë me një numër më të madh të viktimave, duke shfrytëzuar më tepër dhunën për dallim nga, kushtimisht thënë, tregtarët më të vegjël. Tregtarë të caktuar shfrytëzojnë agjencitë e rekrutimit prapa të cilave i fshehin qëllimet e tyre të vërteta. Sipas mënyrës së kryerjes, tregtia pasqyrohet me zbatimin e mjeteve subtile të rekrutimit, që më vonë gjatë kohës së eksploatimit të shfrytëzojë edhe dhunën. Tregtarët përshtaten me ndryshimet teknologjike, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet e mundshme për të punuar në më shumë lokaione njëkohësisht duke shfrytëzuar edhe internetin.

Në aspekt të gjendjes së rajonit ku bën pjesë edhe vendi ynë, pjesa më e madhe e viktimave të zbuluara janë femra të rritura dhe në aspekt të profilit të viktimave, gjendjet nuk kanë ndryshuar dukshëm në aspekt të viteve të kaluara. Në vitin 2018, ka pasur ulje të viktimave vajza dhe një

rritje të vogël të viktimave të zbuluar meshkuj. Gratë dhe vajzat së bashku përbëjnë rreth 75% të viktimave të zbuluara në përgjithësi. Numri më i madh i tyre edhe më tutje janë tregtuar për eksploatim seksual me rritje të vogël të atyre që janë tregtuar për punë të detyrueshme. Shumica e viktimave të zbuluara që janë tregtuar për eksploatim seksual në këtë rajon edhe më tutje janë femra, me ç'rast disa vende kanë zbuluar një numër të konsiderueshëm të vajzave si viktima të kësaj forme të tregtisë. Shtete të caktuara kanë zbuluar edhe viktima të tregtisë me qëllim të kryerjes së aktiviteteve të detyrueshme kriminale, kërkim të lëmoshës dhe martesave të detyrueshme. Tregtia me njerëz për lypje, si dhe tregtia për aktivitete të detyrueshme kriminale janë vërejtur në Ballkanin Perëndimor. Tregtarët e dënuar zakonisht janë meshkuj të rritur dhe pjesa më e madhe janë shtetas të vendit ku ndiqen penalisht.

## Cilat janë format e eksploatimit?

### Eksploatimi seksual

Viktima të eksploatimit seksual më së shpeshti janë gratë dhe vajzat, por nuk përjashtohet që si viktima të ketë edhe burra dhe djem. Krahas prostitucionit të detyrueshëm që është më prezent, kjo formë e eksploatimit mund të përfshijë edhe shfrytëzimin e personave për qëllime pornografike ose eksploatim nëpërmjet shërbimeve seksuale online.

### Puna e detyrueshme

Ky lloj i eksploatimit më së shpeshti ndodh në industrinë ndërtimore, por gjithashtu edhe në bujqësi, blegtori, industri, prodhimtarinë e tekstilit, gastronomi dhe hoteleri. Puna e detyrueshme përfshin punën kundër vullnetit të personit, respektivisht punë në kushte të papranueshme për personin, si dhe punë në kushte shtëpiake (shërbëtor). Puna e detyrueshme shpesh ndodh kur u tregohet njerëzve fillimisht se do të kenë kushte të caktuara të punës, e më pas janë të detyruar të punojnë në kushte krejtësisht ndryshe për pagë minimale ose pa pagesë. Nëse njerëzit ekspozohen ndaj dhunës fizike dhe psikike dhe kanë kufizime të lirisë së tyre të lëvizjes, ata janë ballafaquar me punë të detyrueshme.

### Lypja e detyruar

Lypja e detyruar, gjithashtu, mund të jetë një prej formave të tregtisë me njerëz. Kjo formë e eksploatimit përfshin edhe sakatimin e qëllimshëm trupor dhe detyrimin që të aktrohet një handikep i caktuar për të fituar sa më shumë mjete nga lypja. Ky lloj i eksploatimit në veçanti i godit fëmijët dhe personat më të moshuar.

### Martesa e detyruara

Kjo formë e tregtisë me njerëz përfshin “lidhjen e martesës” të kontraktuar nga prindërit, familjarët ose persona të tjerë për një person të mitur ose pa pëlqimin e personit, nëpërmjet premtimeve të rrejshme dhe mashtrimeve për një jetë më të mirë. Martesa mund të lidhet në vendin ku jeton ose jashtë. Viktimat e këtij lloji të eksploatimit u nënshtrohen shumë llojeve të eksploatimeve nga ana e familjeve ku janë shitur, veçanërisht eksploatimit seksual, lypjes, vjedhjeve, rolit të shërbëtorit.

## Tregtia me organe

Heqja e pjesëve të trupit të njeriut (gjakut, veshkave, qelizave amë, indeve etj.) dhe shitjen e tyre kundër vullnetit të personit ose marrjen e fëmijës nga nëna me qëllim të shitjes së organeve është gjithashtu një lloj i tregtisë me njerëz.

## Detyrim për kryerjen e veprave penale

Viktimat eksploatohen për kryerjen e detyrueshme të aktiviteteve kriminale. Kryerja e krimit të detyruar është një lloj i tregtisë me njerëz dhe viktimat nuk duhet të dënohen për këtë krim.

## Përkufizimi i tregtisë me njerëz

Dokumentet më të rëndësishme për luftimin e tregtisë me njerëz në nivel ndërkombëtar është Protokollin e Palermos nga viti 2002, i cili paraqet plotësim të Konventës kundër krimit të organizuar transnacional nga viti 2000 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Sipas Protokollit, tregtia me njerëz përmban tri elemente themelore: veprimi (çfarë është bërë); mjetet (me të cilat është kryer veprimi) dhe qëllimi (çka është qëllimi kryesor i kryerësit), ku tregtia me njerëz përkufizohet si: *“rekrutimi, transporti, transferimi, strehimi ose pranimi i personave, me ndihmën e kërcënimit ose përdorimit të forcës ose formave të tjera të detyrimit, kidnapimi, mashtrimi, keqpërdorimi i fuqisë ose pozitës së cenuar ose dhënies e pranimi të pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që ka kontroll ndaj një personi tjetër, për qëllimet e eksploatimit. Eksploatimi përfshin, së paku, eksploatimin për prostituimin e të tjerëve ose forma tjera të eksploatimit seksual, punë ose shërbime të detyruara, robëri ose praktika të ngjashme me robërinë, pozitë të shërbëtorit ose marrje të organeve.”*

Në këtë mënyrë, protokollin siguron një përkufizim të përbashkët të tregtisë me njerëz duke vendosur standarde ndërkombëtare. Konfirmohet se tregtia me njerëz mund të paraqitet në disa degë ekonomike dhe se si viktimë mund të jetë gjithkush, e jo vetëm gratë dhe fëmijët, të cilët më së shpeshti lidhen me eksploatimin seksual. Protokollin e merr parasysh edhe ndihmën e viktimave, duke respektuar në tërësi të drejtat e njeriut. Në këtë aspekt, potencohet edhe mbrojtja e privatësisë dhe identitetit, shpërndarja e informatave, akomodimi i viktimës, ndihma mjekësore, psikologjike dhe materiale për të, si dhe arsimimi dhe mundësia për punësim.

Konventa e Këshillit të Evropës (2005) për aksion kundër tregtisë me njerëz paraqet marrëveshje obliguese për luftë efikase kundër tregtisë me njerëz, me një seri të masave minimale, të cilat obligohen që t'i ndër marrin shtetet nënshkruese, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut të personave të tregtuar, parandalimit të tregtisë me njerëz dhe përndjekjen e tregtarëve. Konventa ka të bëjë me të gjitha format e tregtisë me njerëz (shfrytëzimi seksual, eksploatimi për punë, si dhe puna apo shërbimet e detyrueshme), pavarësisht se a ndodh në nivel nacional ose transnacional dhe i mbron të gjitha viktimat e tregtisë me njerëz (gra, burra dhe fëmijë).

Ajo thekson edhe nevojën për t'u ndihmuar viktimave që të riintegrohen në shoqëri, nëpërmjet sigurimit të përkrahjes psikologjike dhe sociale, si dhe akomodimin e sigurt.

## Korniza ligjore në Maqedoninë e Veriut

Kodi penal (KP) me ndryshimet dhe plotësimet e vitit 2002 inkriminon veprë të posaçme dhe serioze penale (Neni 418-a) "Tregti me njerëz" me qenien e tërësishme ligjore të inkorporuar në tërësi sipas nenit 3 nga Protokollin i Palermos. Në vitin 2008, KP është plotësuar me veprë të re penale (Neni 418-g) "Tregti me persona të mitur", ndërsa në vitin 2014, fjala "person i mitur" është zëvendësuar me fjalën "fëmijë".

**Tregtia me njerëz në nenin 418-a (1)** Përfshin atë që me forcë, kërcënim serioz sjell në habi ose forma të tjera të detyrimit, grabitjes, mashtrimit, duke keqpërdorur pozitën e vet ose gjendjen e shtatzënisë, pafuqisë ose paaftësisë fizike ose mentale të tjetrit, ose duke dhënë ose pranuar para ose përfitime të tjera për të marrë pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, ose që të rekrutojë, transportojë, bartë, blejë, shesë, strehojë ose pranojë persona me qëllim të eksploatimit në formë të prostitucionit ose formave tjera të eksploatimit seksual, pornografisë, punës së detyruar, pozitës së shërbëtorit, robërisë, martesave të detyrueshme, fekondimit të detyrueshëm, adoptimit të paligjshëm ose raport të ngjashëm, ose heqjen e palejuar të pjesëve të trupit të njeriut, do të dënohet me dënim me burg prej së paku katër viteve.

**Tregtia me migrantë Neni 418-b** thekson se (1) bartja e paligjshme e migrantëve përtej kufirit shtetëror, si dhe kushdo që prodhon, pajis ose posedon pasaporta false për këtë qëllim, dënohet me të paktën katër vjet burg.

**Organizimi i grupit për nxitje dhe kryerje të veprave tregti me njerëz, tregti me të mitur dhe kontrabandë me migrantë (neni 418-v)**, thekson se (1) Kushdo që organizon një grup, bandë ose shoqatë tjetër për kryerjen e krimeve nga nenet 418-a, 418-b, 418-g dhe 418-d, dënohet me të paktën tetë vjet burg.

**Tregti me fëmijë Neni 418-g** thekson se (1) Një person që rekruton, transporton, blen, shet, strehon ose pranon një fëmijë për shfrytëzim nëpërmjet prostitucionit ose formave tjera të shfrytëzimit seksual, pornografisë, punës së detyruar ose robërisë, skllavërisë, martesat e detyruara, fekondimit të detyruar, birësimit të paligjshëm ose të ngjashme, ose transplantimit të palejueshëm të pjesëve të trupit të njeriut, dënohet me së paku tetë vjet burgim.

**Vënia e marrëdhënies skllavërore dhe transportimi i personave në marrëdhënie skllavërie Neni 418 (1)** Një person i cili, në kundërshtim me rregullat e së drejtës ndërkombëtare, robëron ose skllavëron një tjetër në një marrëdhënie të ngjashme blen, shet, ia dorëzon një personi tjetër ose ndërmetëson në blerjen, shitjen ose transferimin e një personi të tillë ose inkurajon një tjetër për të shitur lirinë e tij/saj ose lirinë e personit që e mbështet ose kujdeset për të, dënohet me burgim nga një deri në dhjetë vjet.

## Mos dënimi i viktimave të tregtisë

Nga data 31.12.2018 inkuadrohet parimi i mosdënimit të viktimave të tregtisë me njerëz me ç'rast në nenin 418-a shtohet paragraf i ri 7 si vijon: “Nuk do të dënohet viktimat e tregtisë me njerëz që është detyruar të kryejë veprë penale ose vepra të tjera të dënueshme deri sa ka qenë viktimë, e që është e lidhur drejtpërdrejt me pozitën e viktimës”. Parimi i mosdënimit të viktimave gjithashtu zbatohet edhe për fëmijët – viktimat të tregtisë me njerëz, respektivisht në nenin 418-g shtohet një paragrafi i ri 8 si vijon: “Nuk do të dënohet fëmijë – viktimë e tregtisë me njerëz në rastet për të cilat ligji parasheh dënimin e fëmijës, kur kryerësi i veprës penale e ka detyruar ta kryejë veprën penale, nëse veprimi i tij i këtillë është pasojë e drejtpërdrejtë e pozitës së viktimës”.

Parimi i mosdënimit ka të bëjë me kryerjen e veprave penale, por edhe të kundërvajtjeve. Në udhëzimet e cekura, me qëllim të zbatimit të drejtë të këtij parimi, është theksuar edhe lista e veprave dhe kundërvajtjeve të mundshme penale kundër rendit dhe qetësisë publike, si dhe kundërvajtjet që mund t'i shqiptohen një të huaji, që duhet të merren parasysh me qëllim të zbatimit të këtij parimi. Kuptimi dhe zbatimi i drejtë i këtij parimi duhet të rezultojë me mosprivimin nga liria, mosarrestimin, mospërndjekjen dhe mosdënimin e viktimës, respektivisht marrjen parasysh të faktit që përfitimi i dobisë financiare nga vepra e tregtisë është shfrytëzuar nga tregtari e jo nga viktimat.

Në vitin 2008, Kodi Penal u plotësua me përkufizimin për **viktimën e veprës penale**. Me viktimë të veprës penale nënkuptohet secili person të cilit i është shkaktuar dëm, përfshi edhe lëndimet fizike ose mentale, vuajtje emocionale, humbje materiale ose shkelje të tjera ose cenim i lirive dhe të drejtave themelore si pasojë e veprës së kryer penale, kurse si fëmijë konsiderohen personat nën moshën 18-vjeçare.

Nocioni “viktimë e tregtisë me njerëz” përkufizohet me Indikatorët e përgjithshëm për identifikimin fillestar/preliminar të viktimave të supozuara dhe potenciale dhe viktimave të tregtisë me njerëz në rastet e lëvizjeve



të përziera të migrimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të miratuara në vitin 2016 nga Qeveria, respektivisht Komisioni Nacional për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe migrimit ilegal.<sup>1</sup>

Korniza juridike nuk bën dallime ndërmjet mbrojtjes së ofruar për kategoritë e ndryshme të viktimave, respektivisht nuk ka dallim në aspekt të trajtimit të viktimave vendase me ato me shtetësi të huaj dhe nuk parasheh dispozita të posaçme me ligj ose me Procedurat Standarde Operative (PSO) në aspekt të viktimave që janë identifikuar jashtë vendit dhe janë kthyer në RMV.

## Procedura penale

Me dispozitat e nenit 53 nga Ligji për Procedurë Penale (LPP), të drejtat themelore të viktimës përbëhen nga e drejta për pjesëmarrje në procedurën penale si i/e dëmtuar, duke iu bashkëngjitur përndjekjes penale ose për realizimin e kërkesës pronësoro-juridike për dëmshpërbim, të drejtën e kujdesit dhe vëmendjes së posaçme nga ana e organeve dhe subjekteve që marrin pjesë në procedurën penale, për ndihmë efektive psikologjike dhe ndihmë dhe përkrahje tjetër profesionale nga ana e organeve, institucioneve dhe organizatave për ndihmë të viktimave të veprave penale.

Policia, prokurori publik dhe gjykata kanë obligim ligjor të vepronë me kujdes të veçantë ndaj viktimave të veprave penale, duke iu dhënë udhëzime për të drejtat e tyre dhe duke u kujdesur për interesat e tyre gjatë sjelljes së vendimeve për përndjekje penale kundër të akuzuarve, respektivisht gjatë marrjes së veprimeve në procedurë penale në të cilat viktimat patjetër duhet të jetë e pranishme. Obligimi i këtillë fillon me kontaktin e parë të viktimës me sistemin penal-juridik, e që zakonisht kjo është policia. Më tutje, garantohet zbatimi i të drejtave të viktimave, si dhe realizimi i obligimeve të parapara ligjore nga institucionet e lartpërmendura.

Viktima ka të drejtë që gjatë deklarimit, respektivisht parashtrimit të kërkesës

<sup>1</sup> <https://bit.ly/3EdtKRU>

pronësore-juridike të ketë këshilltar në llogari të mjeteve buxhetore. Më tutje, patjetër duhet të ketë lidhshmëri me kushte subjektive, respektivisht vuajtja e viktimës që është shprehur nëpërmjet dëmtimeve të rënda psikofizike ose pasojave më të rënda sipas Kodit penal, është në dispozicion të viktimave të tregtisë me njerëz. I njëjti kusht përcaktohet edhe për të drejtën e viktimave për dëmshpërblim material ose jomaterial nga fondi shtetëror. Krahas të drejtave themelore të viktimës, me rëndësi dhe dobi të veçantë është edhe fakti që LPP parasheh të drejta të posaçme për viktimat. Për herë të parë, pranohen kategoritë e cenueshme të viktimave. Neni 54 parasheh të drejtën e masave të posaçme të mbrojtjes gjatë procesit të dhënies së deklaratës ose intervistimit gjatë të gjitha fazave të procedurës. Ligji i dallon kategoritë e cenueshme të viktimave dhe viktimat me ndjeshmëri të veçantë. Bazat e posaçme për përcaktimin e masave të veçanta të mbrojtjes gjatë procesit janë moshën, e pasuar nga cenueshmëria e sigurisë personale të viktimës, si dhe rrethanat dhe karakteristikat e viktimës që mundin negativisht të ndikojnë në kualitetin e deklaratës së dhënë. Masat e posaçme të mbrojtjes procedurale i përcakton gjykata me propozim të prokurorit publik ose viktimës, ose sipas vlerësimit personal kur nevojitet mbrojtja e viktimave të cenueshme ose me ndjeshmëri të posaçme. Gjatë vendimmarrjes për përcaktimin e masave të veçanta të mbrojtjes procedurale, gjykata patjetër duhet ta marrë parasysh vullnetin e viktimës. Gjykata mund të përcaktojë njëkohësisht një ose më tepër masa të posaçme për mbrojtje procedurale. Viktimat në mënyrë plotësuese kanë të drejtë falas për avokat ose përfaqësues, përjashtimin e publikut, si dhe hetim duke shfrytëzuar mjetet vizuale-tonike, ose shmangien e kontaktit personal me të akuzuarin.

## Drejtësia për fëmijët <sup>2</sup>

Fëmijët – viktimat dhe/ose dëshmitar të veprave penale kanë të drejtë për mbrojtje dhe përkrahje të shtuar nga të gjitha institucionet dhe organet. Fëmijët viktimat të veprës penale gëzojnë mbrojtje të posaçme nga viktimizimi sekondar ose riviktimizimi, mbrojtja nga diskriminimi, respektimi i dinjitetit, ndihma

<sup>2</sup> Ligji për Drejtësi të Fëmijëve (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 148/13, dhe Gazeta zyrtare e RMV-së 152/19,275/19).

profesionale dhe përkrahja e të gjitha institucioneve dhe organizatave, e drejta e privatësisë, të informohen në gjuhën që e kuptojnë, për mbrojtje të posaçme të sigurisë personale dhe sigurisë së familjes, të bashkëngjiten në procedurën e përndjekjes penale ose realizimit të kërkesës pronësore-juridike për dëmshpërblim nga fondi shtetëror, nëse kompensimi i dëmit nuk mund të sigurohet nga i dënuari.

Konkretisht, fëmijët-viktima të tregtisë me njerëz kanë të drejtë për masa të veçanta për mbrojtje procedurale. Sipas nenit 146 të këtij ligji, gjykata përcakton në veçanti ose së bashku me masat e tjera të veçanta të mbrojtjes, që të regjistrohet deklarimi i fëmijës me regjistrim video dhe tonik, që do të shfrytëzohet si argument gjatë procedurës së mëtutjeshme. Në raste të jashtëzakonshme, nëse paraqiten rrethana të reja, gjykata mund ta marrë përsëri në pyetje fëmijën-viktimë më së shumti edhe një herë, duke shfrytëzuar mjete teknike për komunikim.

Në aspekt të masave speciale për mbrojtjen e viktimave të mitura, legjislati vendos parasheh: Legjislati vendos ta pranojë parimin “në interes më të mirë të fëmijës” si pikënisje primare gjatë të gjitha procedurave dhe vendimeve që kanë të bëjnë me viktimën e mitur.<sup>3</sup> Korniza juridike parasheh kujdestar ligjor, organizatë ose institucion për secilin fëmijë që nuk ka përkujdesje, që konsiderohet si viktimë e mundshme e tregtisë me njerëz.<sup>4</sup>

Secili person i mitur që është viktimë potenciale dhe viktimë e tregtisë me njerëz duhet të fitojë ndihmë juridike falas nga një avokat ose përfaqësues ligjor edhe kur viktimë nuk pajtohet që të bashkëpunojë me organet gjyqësore, respektivisht para se të fillojë bisedën me përfaqësuesit e NJNLKMTNJ si dhe NJLTNJKM, viktimës i kumtohet edhe e drejta juridike falas.<sup>5</sup>

<sup>3</sup> Ky parim përmendet në Ligjin për Drejtësinë për Fëmijët (neni 21), PSO për trajtimin e fëmijëve të huaj të pashoqëruar nga viti 2015, dhe përkufizimi i këtij parimi gjendet në PSO të vitit 2018.

<sup>4</sup> Parashikohet në PSO nga viti 2018 në pjesën për identifikim dhe PSO speciale për trajtimin e fëmijëve të huaj të pashoqëruar, të miratuar në vitin 2015.

<sup>5</sup> Është rregulluar më tej në PSO sa i përket mbledhjes së provave me mbështetjen e viktimës.

## Mbrojtja e dëshmitarëve

---

Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve<sup>6</sup> parasheh qasje në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve që fitohet me vendim të Këshillit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe me marrëveshje paraprake për mbrojtje ndërmjet personit të mbrojtur dhe Seksionit për mbrojtjen e dëshmitarëve. Ligji krahas procedurës dhe kushteve për ofrimin e mbrojtjes dhe ndihmës për dëshmitarët, parasheh edhe procedurë dhe kushte për dhënien e ndihmës për personat e afërt të bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe viktimave që paraqiten në cilësi të dëshmitarëve. Korniza juridike parasheh mundësinë për ndryshimin e identitetit të viktimave të tregtisë me njerëz dhe ruajtjen në fshehtësi të identitetit, mundësinë e mbrojtjes fizike të viktimave të tregtisë me njerëz dhe mundësinë për shpërnguljen e viktimës, si masë mbrojtëse.

---

<sup>6</sup> Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 38/2005, 58/2005 dhe 71/2018.

## Mbrojtja e të huajve që janë viktimë e tregtisë me njerëz

Korniza juridike nuk i kushtëzon viktimat e mundshme të tregtisë me njerëz në mënyrë që do t'u garantojë ndihmë dhe përkrahje elementare vetëm në këmbim të gatishmërisë së tyre për të akuzuar/dëshmuar kundër kryerësve/të dyshuarve për veprat penale.

Personit të huaj, që është viktimë e tregtisë me njerëz, i mundësohet një periudhë e rikuperimit dhe reflektimit në kohëzgjatje prej dy muajve me qëllim që të ofrohet mbrojtje dhe ndihmë gjatë rikuperimit dhe shmangies së ndikimit të kryerësve të veprës penale "Tregti me njerëz". Në rast kur viktima është fëmijë, periudha 2-mujore mund të vazhdohet, duke u nisur nga interesat më të mira për fëmijën. Gjatë periudhës së rikuperimit dhe reflektimit, personi i huaj që është viktimë e tregtisë me njerëz duhet të sjellë vendim nëse do të bashkëpunojë me organet kompetente shtetërore për zbulimin e veprave penale dhe përndjekjen e kryerësve të tyre ose do të kthehet në shtetin e tij amë, ose aty ku ka të rregulluar vendqëndrimin ligjor. Në këtë drejtim, periudha e rikuperimit dhe reflektimit nuk është e kushtëzuar me bashkëpunimin e viktimës me organet kompetente shtetërore.<sup>7</sup> Gjatë periudhës së reflektimit, viktima akomodohet në një hapësirë të posaçme të Qendrës strehuese për të huajt pranë Ministrisë për Punë të Brendshme, kurse pas miratimit të qëndrimit të përkohshëm transferohet në Qendrën për personat viktima të tregtisë me njerëz dhe dhunës seksuale pranë Ministrisë për Punë dhe Politikë Socjale. Gjatë periudhës së rikuperimit dhe reflektimit, viktima ka të drejtë për akomodim adekuat dhe të sigurt; ndihmë mjekësore dhe psiko-sociale; ndihmë materiale; përkthim dhe interpretim të këshillave dhe informatave për të drejtat e tyre ligjore, si dhe ndihmë juridike gjatë procedurave penale dhe procedurat tjera ku viktima e tregtisë me njerëz i realizon të drejtat e tij të përcaktuara me ligj. Viktimës do t'i miratohet qëndrimi i përkohshëm për arsye humanitare edhe nëse nuk i plotëson kushtet për miratimin e qëndrimit të përkohshëm, ndërsa do të miratojë

<sup>7</sup> Ligji për të huajt, neni 121.

edhe qëndrimin e përkohshëm për qëllime humanitare të një fëmije-të huaj pa dallim të statusit të viktimës. Në periudhën e rikuperimit dhe reflektimit të viktimës do t'i jepet leje për qëndrim të përkohshëm, nëse: qëndrimi i viktimës është i domosdoshëm për shkak të gjendjes së tij/saj personale ose kur qëndrimi është i domosdoshëm për shkak të bashkëpunimit me organet kompetente shtetërore për zbulimin e veprave penale dhe përndjekjen e kryerësve të tyre. Qëndrimi i përkohshëm do të miratohet për një periudhë gjashtëmujore dhe i njëjti do të vazhdohet nëse ekzistojnë kushte.

Qëndrimi i përkohshëm i viktimës do t'i merret nëse e keqpërdor ose humb statusin e viktimës së tregtisë me njerëz ose nëse paraqet rrezik për rendin publik dhe sigurinë kombëtare të RMV-së. Vlen të theksohet se viktima deri sa është në periudhën e reflektimit dhe gjatë qëndrimit theksohet në mënyrë të prerë se nuk mund të dëbohet nga RMV, me çka garantohet edhe parimi i moskthimit të viktimës. E njëjta vlen edhe për fëmijë-të huaj, pa dallim nëse ka status të viktimës, nuk guxon të kthehet në shtetin amë ose në një shtet tjetër pajtohet për ta pranuar, derisa në atë shtet nuk i sigurohen kushte adekuate të pranimit. Fëmija në asnjë rast nuk guxon të kthehet në një shtet tjetër ku kthimi i tij do të ishte në kundërshtim me Konventën për të drejtat e fëmijëve, Konventën për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

Janë paraparë<sup>8</sup> dy dispozita që udhëzojnë për veprimin me viktimat e tregtisë, respektivisht sipas rregullores, nëpunësi policor në vendkalimin kufitar duhet të veprojë me kujdes të posaçëm ndaj personave që janë viktima potenciale të tregtisë me njerëz, të miturit e pashoqëruar, si dhe personat e tjerë të cenueshëm në pajtim me ligjin, duke i zbatuar rregullat ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të këtyre personave. Gjithashtu, me këtë rregullore parashihet se në rast të rregullimit të vendqëndrimit të përkohshëm të një të huaji për arsye humanitare, për të cilin ekzistojnë dyshime se është viktimë e veprës penale "tregti me njerëz", kërkesa për lejimin e qëndrimit të përkohshëm parashtrohet te personi i autorizuar i njësisë organizative kompetente të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

<sup>8</sup> Rregullorja për të Huaj (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 190/2019)

## Ndihma dhe përkrahja e viktimave

Ligji për familjen<sup>9</sup> rregullon përgjegjësinë e prindërve ndaj fëmijëve, përcakton moshën minimale për martesë dhe mundëson mbrojtjen e fëmijëve viktimë të TNJ në kreun V-a “Kujdestaria ndaj personave të mitur, viktimë të TNJ.” Në të parashihen masa për mbrojtjen e personalitetit, të drejtat dhe interesat e fëmijës dhe caktimi i kujdestarit.

Ligji për mbrojtjen e fëmijëve<sup>10</sup> i mbron fëmijët nga të gjitha llojet e eksploatimit, shfrytëzimit komercial dhe keqpërdorimit të fëmijëve, nëpërmjet dispozitave që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me mbrojtjen e tyre.

Ligji për Mbrojtje Sociale<sup>11</sup> parasheh shërbime gjatë qëndrimit të përkohshëm, siguron mbrojtje dhe ndihmë profesionale për personat që gjenden në gjendje krize, me qëllim të tejkalimit të gjendjes dhe integrimin e tyre social (neni 83).

Ligji për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë<sup>12</sup> me të cilin rregullohen çështjet për shkëmbimin e punës, të drejtat dhe obligimet e punëdhënësve, personat e papunë dhe persona të tjerë të cilët kërkojnë punë; Ligji për punësimin dhe punën e të huajve<sup>13</sup> i rregullon kushtet dhe procedurat me të cilat të huajt mund të punësohen ose punojnë në RMV, përveç nëse është e rregulluar ndryshe me ratifikimin e një marrëveshje ndërkombëtare.

<sup>9</sup> Ligji për Familjen (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 80/1992, 9/1996, 38/2004, 33/2006, 84/2008, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38 / 14,115 / 14 и 104 / 15 dhe 150/2015).

<sup>10</sup> Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve <https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/pravilnicidetska/2020/29.6-%DO%94%DO%97.pdf> (teksti i pastruar qershor 2020)

<sup>11</sup> Ligji për Mbrojtjen Sociale, Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 104 i dates 23.5.2019.

<sup>12</sup> Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.153 e datës 6 dhjetor 2012.

<sup>13</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 217/2015).

Në vitin 2008, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut e miratoi, ndërsa në vitin 2010, respektivisht 2018, i rishqyrtoi **Procedurat Standarde Operative për veprim me viktimat e tregtisë me njerëz** (në tekstin e mëtejshëm: PSO) me të cilat mundësohet ndihma dhe mbrojtja e të gjitha viktimave të tregtisë me njerëz nëpërmjet një qasjeje gjithëpërfshirëse, të bazuar në të drejtat e njeriut të viktimave. PSO kanë për qëllim që të mundësojnë një veprim dhe partneritet të koordinuar nga të gjitha institucionet dhe organizatat e interesuara, në luftën kundër tregtisë me njerëz në nivel lokal, nacional dhe ndërkombëtar. Dokumenti jep udhëzime lidhur me procedurat dhe masat që duhet të ndërmerren me qëllim që të identifikohen dhe udhëzohen viktimat e tregtisë me njerëz; ndihmë të koordinuar dhe përkrahje të viktimave të tregtisë me njerëz; risocializim dhe riintegrim; kthim të viktimës dhe procedurës penale. Sipas PSO, procedura për identifikimin e viktimave është urgjente dhe kërkon një reagim të shpejtë për përcaktimin e identitetit të viktimës, vlerësimin e rrezikut dhe sigurimin e informatave për viktimën, në gjuhën që e kupton. Pas identifikimit, institucionet dhe organizatat kompetente janë të obliguara që të fokusohen në ndihmën dhe përkrahjen e viktimës, duke identifikuar nevojat specifike të viktimës dhe përgatitjen e planit individual për ndihmë me të cilin duhet të pajtohet edhe viktimja për ta zbatuar. PSO, krahas ligjeve që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e viktimës në procedurë penale, në mënyrë të detajuar i përshkruan edhe intervenimet që duhet të ndërmerren për ndihmë dhe përkrahje të viktimës gjatë kohëzgjatjes së procedurës penale.



## Elementet e tregtisë me njerëz

Për ta kuptuar tregtinë me njerëz, duhet të dihen këto tre elemente:

TREGTIA ME NJERËZ		
AKTIVITETI	MJETET	QËLLIMI
Rekrutimi Mashtrimi Transporti Bartja Strehimi Pranimi i personave	Kërcënimi ose përdorimi i forcës Detyrimi Kidnapimi Mashtrimi Gënjimi Keqpërdorimi i fuqisë ose cenueshmërisë Dhënia e pagave ose përfitimeve	Eksploatimi, përfshi: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Prostitucionin e personave të tjerë</li> <li>• Eksploatimin seksual</li> <li>• Punën e detyrueshme</li> <li>• Robërinë ose praktika të ngjashme</li> <li>• Heqjen e organeve</li> <li>• Lloje të tjera të eksploatimit</li> </ul>

Akti nënkupton **aktivitete** konkrete që i ndërmerr një person i caktuar, kryerës i veprës penale të tregtisë me njerëz. Këto aktivitete më së shpeshti janë: mashtrimi, transporti, bartja, strehimi, pranimi i personit, shitja, blerja.

**Mjetet** tregojnë se si një person bëhet viktimë e tregtisë me njerëz, si nënshtrohet, respektivisht si krijohet dhe mbahet kontrolli ndaj tij. Më së shpeshti kjo bëhet nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës ose formave të tjera të detyrimit, grabitjes, mashtrimit, hutisë, keqpërdorimit të fuqisë së kryerësit ose të gjendjes së viktimës, apo duke dhënë ose marrë para ose përfitime tjera për të marrë pëlqimin e personit që ka kontroll ndaj personit tjetër.

**Qëllimi i eksploatimit** të një personi tjetër për përfitime personale është element i domosdoshëm i tregtisë me njerëz. Qëllimi i eksploatimit përfshin, si minimum, eksploatimin për prostitucion ose forma të tjera të eksploatimit seksual, punës së detyruar ose robërisë, ose diçka të ngjashme me robëri, pozitë të shërbëtorit ose heqjen e organeve. Këtu është me rëndësi që të mbahet mend se elementi esencial i tregtisë me njerëz është qëllimi që të eksploatohet një person i caktuar. Për këtë arsye, tregtia me njerëz definohet si krim me qëllim të posaçëm dhe së këndejmi edhe nuk duhet që të kryhet akti i eksploatimit, për ta karakterizuar aktivitetin si tregti me njerëz.

Në rast<sup>14</sup> se bëhet fjalë për fëmijë, elementi “mjete” nuk është i nevojshëm. Nevojitet të tregohet vetëm “akti”, siç janë rekrutimi, blerja dhe shitja dhe se ky aktivitet ka pasur si qëllim specifik eksploatimin. Me fjalë të tjera, tregtia me fëmijë do të ekzistojë nëse fëmija është ekspozuar ndaj ndonjë akti, siç është rekrutimi ose transporti, ku si qëllim është eksploatimi i fëmijës.

<sup>14</sup> [https://www.ohchr.org/Documents/Publications/FS36\\_en.pdf](https://www.ohchr.org/Documents/Publications/FS36_en.pdf)

## Kriumçareње мигранти v.s.v трговија со луѓе

Kontrabanda me njerëz dallohet nga tregtia, fillimisht për faktin se kontrabanda zakonisht nuk e ka elementin e detyrimit, mashtrimit e as eksploatimit të njëpasnjëshëm, respektivisht nuk ekziston element i cili e kufizon lirinë e vullnetit të personit të kontrabanduar.<sup>15</sup> Raporti i kontrabandistit dhe njerëzit që i kontrabandon, zakonisht ndërpritet pas kalimit të kufirit, respektivisht, personi i kontrabanduar mundet pa kurrfarë pasojash në çdo kohë ta ndërpresë raportin me kontrabandistin, ndërsa personi që është viktimë e tregtisë me njerëz nuk mund ta ndërpresë këtë raport pa pasoja të konsiderueshme.

Më tutje, gjatë kontrabandës nuk ka ose ka shumë rrallë ndëshkime sistematike fizike, psikike dhe seksuale. Për kontrabandën është karakteristike fakti që gjithmonë bëhet gjatë kalimit ilegal të kufirit. Në këtë aspekt, kjo vepër penale konsiderohet si vepër penale kundër shtetit, e jo kundër individit.

DALLIMET	TREGTIA ME NJERËZ	KONTRABANDA
Qëllimi/ si përfitohet	Ekziston një eksploatim i vazhdueshëm i viktimës edhe pas arritjes në destinacionin e fundit	Përfitimi i njëhershëm financiar duke paguar një shumë të caktuar të parave për transferim ilegal të personave përtej kufirit.
Çështja e pëlqimit (marrëveshja)	Nuk ekziston pëlqim ose pëlqimi është marrë me dhunë, mashtrim ose detyrim.	Ekziston pëlqim dhe marrëveshje ndërmjet imigrantit dhe kontra-bandistit rreth detajeve për rrugën, rutën dhe çmimin e këtij shërbimi.

<sup>15</sup> International Organization for Migration (IOM). (2007). THE IOM HANDBOOK ON Direct Assistance for Victims of Trafficking, Geneva. [http://www.iom.int/jahia/webdav/site/myjahiasite/shared/shared/mainsite/published\\_docs/books/CT%20handbook.pdf](http://www.iom.int/jahia/webdav/site/myjahiasite/shared/shared/mainsite/published_docs/books/CT%20handbook.pdf)

Lëvizja	Në kuadër të vendit amë ose përtej kufirit	Gjithmonë përtej kufirit (ilegalisht ose në vendkalime legale kufitare duke përdorur dokumente të falsifikuara ose të vjedhura të udhëtimit)
Elementet e kontrollit	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lidhje borxhi</li> <li>- Privimi nga liria</li> <li>- Kërcënime</li> <li>- Dhunë</li> </ul>	Klientët rrallë kontrollohen
Lidhja -Tregtari me njerëz - viktima -Kontrabandues - Klient	Tregtar me njerëz - Viktima Lidhja vazhdon edhe në vendin e destinacionit të fundit	Kontrabandues-Klient Lidhja ndërpritet pas kalimit të kufirit të vendit – destinacionit.

Prapëseprapë, kontrabandimi mund të bëhet hyrje në tregtinë me njerëz dhe të rritet në tregti, nëse lidhja me imigrantët dhe kontrabandistit nuk ndërpritet këtu, por do të shndërrohet në raport për eksploatim në të cilin kontrabandisti do ta kontrollojë imigrantin. Gjithashtu, njerëzit që janë të kontrabanduar në një shtet tjetër janë të ekspozuar ndaj rrezikut që të bëhen viktima të tregtisë me njerëz<sup>16</sup>.

<sup>16</sup> Inter-Parliamentary Union (IPU) & United Nations Office of Drugs and Crime (UNODC). (2009). Combating trafficking in persons: A handbook for parliamentarians. Vienna, Austria.: <http://www.ipu.org/pdf/publications/traffickingp-e.pdf>

# SESIONI II.

## IDENTIFIKIMI I VITKIMAVE TË TREGTISË

Procedura e identifikimit është përcaktuar sipas Procedurave Standarde Operative (PSO) për veprim me viktimat e tregtisë me njerëz.<sup>17</sup> Në pajtim me PSO për veprim me viktimat e tregtisë me njerëz, identifikimi i viktimave është proces me të cilin nëpërmjet disa indikatorëve dhe intervistave, fitohen informata në bazë të së cilave bëhet vlerësimi nëse një person i caktuar është viktimë e tregtisë. Ky proces është urgjent dhe përfshin disa nënprocedura.

Ekzistojnë disa procedura të veçanta për identifikimin e fëmijëve-të huaj pa shoqërues dhe të kategorive të cenueshme të personave-të huaj, që parashihen me PSO për veprim me fëmijët-të huaj<sup>18</sup> pa shoqërim, që nga nëntori i vitit 2015, respektivisht PSO për veprim me kategoritë e cenueshme të personave-të huaj<sup>19</sup>, që nga korriku i vitit 2016. Gjithashtu ekzistojnë edhe lista të indikatorëve për identifikimin e viktimave të tregtisë me njerëz<sup>20</sup> si dhe indikatorë për identifikimin e parë/preliminar të viktimave të supozuara dhe potenciale të tregtisë me njerëz në rastet e lëvizjeve të përziera migruese.

---

<sup>17</sup> <http://nacionalnakomisija.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/MK-SOP.pdf>. Këto procedura përgjatë vitit 2018 janë rishqyrtuar dhe në pjesën e dytë të vitit janë miratuar nga Qeveria e RM-së në seancën nr. 102, pika nr. 31.

<sup>18</sup> <http://nacionalnakomisija.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/SOP-za-postapuvanje-so-nepridruzuvani-deca-stranci.pdf>

<sup>19</sup> <http://nacionalnakomisija.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/SOP-za-postapuvanje-so-ranlivi-kategorii-lica-stranci.pdf>

<sup>20</sup> [https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/Indikator\\_i\\_trgovija.pdf](https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/Indikator_i_trgovija.pdf)

## Përse ka rëndësi identifikimi i viktimave?

Identifikimi i viktimave i përfshin të gjitha hapat që ndërmerren për të vlerësuar nëse ndonjë person ose grup janë viktimë e TNJ, respektivisht nuk janë vetëm imigrantë ilegalë, imigrantë të kontrabanduar ose persona të përfshirë në raste të tjera.

Nga ana tjetër, migrimet ilegale që realizohen nëpër rrugë të rrezikshme, nëpër shumë vende që kanë politika të ndryshme në aspekt të lëvizjeve të përziera të migrimit i bëjnë imigrantët të cenueshëm në aspekt të tregtisë me njerëz dhe eksploatimit.

Identifikimi i drejtë është kyç edhe për mundësimin e shpejtë të kujdesit për viktimat që shpeshherë ballafaqohen me probleme serioze shëndetësore (fizike ose psikologjike, ose pasoja ndaj organeve seksuale dhe reproduktive), probleme juridike dhe çështje të sigurisë.

Identifikimi është shumë i rëndësishëm, sepse shumë viktimat kanë përjetuar riviktimizim për faktin që janë trajtuar si kriminelë ose imigrantë ilegalë, e jo si viktimat e një veprë serioze penale.

Institucionet dhe trupat përgjegjëse, në bazë të roleve dhe përgjegjësi të tyre të rregullta për zbatimin e ligjit, vijnë në kontakt edhe me persona të tregtuar. Për këtë arsye, ka rëndësi kyç edhe fakti që personat profesional të vijës së parë duhet të pajisen me aftësi dhe shkathtësi për identifikimin, udhëzimin, mbrojtjen dhe ndihmën në kohë të viktimave të TNJ.

Identifikimi i viktimës ka rëndësi të jashtëzakonshme për si vijon:

- Shpëtimin e viktimave nga ai zinxhir
- Marrjen e mbrojtjes dhe ndihmës në kohë
- Kthimin e të drejtave të viktimave

- Parandalimin e procesit të tregtisë me njerëz dhe parandalimin e eksploatimit të individëve dhe
- Përndjekjen e kryerësve.

Procesi i identifikimit të personave të tregtuar është i komplikuar, respektivisht sikurse të gjitha aktivitetet kriminale, tregtarët me njerëz bëjnë përpjekje maksimale që të sigurohen se aktivitetet e tyre nuk do të zbulohen dhe viktimat do të qëndrojnë të nënshtruara. Fatkeqësisht viktimat e TNJ rrallë identifikohen për shkak të natyrës së vetë përvojës së tregtisë me njerëz dhe eksploatimit.



## Sfidat e identifikimit të viktimës së tregtisë me njerëz

Për dallim nga krimet e tjera, viktimat e TNJ rrallë vetë identifikohen si viktima dhe pothuajse asnjëherë nuk e paraqesin rastin para organeve përgjegjëse. Mungesa e informimit varet nga disa faktorë, si vijon:

- Frika nga trafikantët ose për shkak të përdorimit të forcës ose kërcënimeve të dhunshme ndaj viktimës ose familjes dhe të afërmeve.
- Për të mbijetuar, viktimat pranojnë teknika të ndryshme negative për ballafaqim, si fshirjen nga kujtesa, marrjen e roleve të të moshuarve në rastet e fëmijëve, shmangien e bisedave për përvojat ose imitimën e sjelljes së dhunuesit.
- Mund të vuajnë nga sindromi i Stokholmit<sup>21</sup>, ku me kalimin e kohës ata kanë zhvilluar një lidhshmëri të gabuar/lidhje me trafikuesin.
- Mund të vuajë nga stresi posttraumatik dhe humbja e memories – pasojë e shpeshtë nga tregtia me njerëz, veçanërisht në rastet kur viktima ka përjetuar vuajtje serioze nga duart e trafikantëve siç janë përdhunimi, rrahja, keqpërdorimi etj.;
- Barriera gjuhësore dhe mungesa e besimit në institucione
- Mungesa e dokumentacionit, frikës nga burgu ose deportimi.

<sup>21</sup> Sindroma e Stokholmit është një term përshkruar për një model të trajtimit të një situatë traumatike dhe jo një kategorie diagnostike. Shumica e psikiatërve do të përdorin kriteret diagnostikuese për çrregullimin akut të stresit ose çrregullimin e stresit post-traumatik kur vlerësojnë një person me sindromën e Stokholmit. Stockholm Syndrome. (n.d.). The Free Dictionary. Retrieved from <http://medical-dictionary.thefreedictionary.com/Stockholm+syndrome>.

## Procesi i identifikimit të viktimave

Procesi i përgjithshëm i identifikimit të viktimave bazohet në tentativën për të lidhur karakteristikat e viktimave me elementet kyçe gjatë përku-fizimit të tregtisë me njerëz. Procesi i identifikimit të VTNJ është proces i dyfishtë:

- Mbikëqyrja dhe vlerësimi i indikatorëve të tregtisë me njerëz; dhe
- Zbatimi i intervistës për skringun.

Edhe pse trafikantët mundohen t'i fshehin krimet e tyre, personat përgjegjës mund t'i zbulojnë viktimat ose viktimat potenciale të TNJ gjatë fazave të ndryshme të procesit të tregtisë me njerëz, me çka do t'i mbikëqyrin treguesit-indikatorët e përbashkët që kanë lidhje me tregtinë me njerëz.

Në pajtim me procedurat standarde operative në RMV, identifikimi paraqet një proces urgjent gjatë të cilit nëpërmjet mbledhjes së informatave dhe një sërë indikatorësh, konstatohet nëse një person i caktuar është viktimë e tregtisë me njerëz. Pas kontaktit fillestar me personin dhe konstatimit të rrethanave që tregojnë se ka dyshime të arsyeshme se personi është viktimë potenciale e tregtisë me njerëz, personi udhëzohet deri te organi kompetent për udhëzime të mëtutjeshme.

Organet kompetente për udhëzimin e parë janë Mekanizmi nacional për udhëzime, Qendra e Punëve Sociale, Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale dhe Njësia për tregti me njerëz dhe kontrabandë të imigrantëve dhe Njësia nacionale për luftimin e kontrabandës së imigrantëve dhe tregtisë me njerëz.

Organi kompetent e konstaton identitetin e viktimës potenciale, mbledh informata nga viktimat dhe i përcakton nevojat e saj urgjente. Në bazë të të dhënave të mbledhura dhe duke shfrytëzuar indikatorët, bëhet vlerësimi i hershëm i rrezikut. Përfundimisht, me qëllim të konstatimit të të gjitha fakteve dhe rrethanave të rëndësishme për procedurën me vik-

timën potenciale dhe realizohet një intervistë për konstatimin e statusit të viktimës së tregtisë me njerëz. Nëse viktima ka nevojë për ndihmën e përkthyesit, intervista realizohet në gjuhën që e kupton viktima.

Nëse konstatohet statusi i viktimës së tregtisë me njerëz, pason një periudhë e reflektimit dhe rikuperimit, gjatë së cilës viktima qëndron në Qendrën për viktimat e tregtisë me njerëz ose Qendrën e strehimit për të huajt. Për secilën viktimë emërohet një person përgjegjës, respektivisht nëpunës policor nga Njësia e tregtisë me njerëz dhe kontrabandë me imigrantë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, respektivisht Njësia nacionale për luftimin e kontrabandës me imigrantë dhe tregtisë me njerëz, që është përgjegjës për viktimat e tregtisë me njerëz, deri në përfundim të periudhës së reflektimit dhe rikuperimit, respektivisht deri në lëshimin e Qendrës për viktima ose Qendrës strehuese për të huajt.

## Vlerësimi i indikatorëve

Indikatorët për identifikimin e viktimave/fëmijëve viktimë të tregtisë me njerëz janë pjesë ndihmëse gjatë identifikimit kualitativ dhe në kohë të viktimave, që mundëson identifikimin më të shpejtë dhe në kohë të viktimave të TNJ dhe fëmijëve-viktima. Ndarja e indikatorëve direkt dhe indirekt përcakton se kush do të praktikojë cilat indikatorë. Një herë janë dhënë edhe indikatorë specifikë për format e ndryshme të identifikimit dhe indikatorët e posaçëm për fëmijë.

Indikatorët e përgjithshëm në vazhdim ndihmojnë në identifikimin e personave që mund të jenë viktimë të TNJ.

👉 **Mosha e viktimës:** Varësisht nga qëllimi i eksploatimit të tregtisë me njerëz, ka rëndësi edhe mosha e viktimës. Shpeshherë gratë dhe vajzat e reja janë objekt i eksploatimit seksual si kërkesë e klientëve. Në rastet e eksploatimit të punës, kërkesa për persona të rinj dhe të fuqishëm që janë produktiv dhe që mund t'u qëndrojnë sfidave për punë të rëndë. Për lypje dhe shitje në rrugë janë më të moshuarit, personat me pengesa dhe fëmijët e vegjël të cilët zgjojnë ndjenjat e kalimtarëve dhe për këtë arsye janë cak më fitimprurës dhe më i qëlluar për trafikantët me njerëz. Fëmijët, veçanërisht fëmijët e huaj pa shoqërues, janë tejet të cenueshëm ndaj tregtisë me njerëz, sepse prej tyre më lehtë merret pëlqimi dhe janë më të nënshtuar ndaj frikësimit. Ata mund të eksploatohen në mënyra të ndryshme: në industrinë seksuale, pornografinë e fëmijëve, birësimin e detyrueshëm, lypje, vjedhje, si dhe si “robër” shtëpiakë dhe tregti me organe.

👉 **Gjinia e viktimës:** Për shkak të pabarazive gjinore që janë të ngulitura, pozita në shoqëri dhe qëndrimet dhe normat negative i bëjnë gratë dhe vajzat më të cenueshme ndaj tregtisë me njerëz për qëllim të eksploatimit seksual, pozitës së shërbëtores në shtëpi, martesave të detyruara etj. Ndërsa, nga ana tjetër, djemtë dhe burrat janë më të cenueshëm që të rekrutohen me dhunë për të kryer vepra penale, për forma të caktuara të eksploatimit të punës, konflikteve të armatosura etj.

- **Keqpërdorimi:** Shenjat e dukshme të keqpërdorimit fizik ndaj një personi mund të jenë tregues për tregti me njerëz, siç janë lëndimi fizik, frakturat, të ënjturat, infektimet, sytë e errët, tatuazhe të caktuara në trupin e viktimës, veshje e grisur dhe e keqe. Mirëpo, nuk duhet supozuar se një person nuk është tregtuar nëse nuk ka shenja të lëndimit ose keqpërdorimit fizik.
- **Vendi i origjinës:** Trafikantët e marrin parasysh cenueshmërinë e njerëzve, shpresat dhe ëndrrat për jetë më të mirë nga vështirësitë e tyre të tanishme, që janë karakteristike për vendin e origjinës (siç janë varfëria, konfliktet, kriza humanitare, diskriminimi gjinor, mungesa e mundësive dhe përmirësimit ekonomik).
- **Dokumentacioni:** Shpeshherë, viktimat e tregtisë me njerëz shfrytëzojnë identitetet ose dokument udhëtimi nga një person tjetër. Mungesa e dokumenteve të udhëtimit dhe letërnjoftimeve të rrejshme janë indikatorë të fuqishëm për tregtinë me njerëz.
- **Transporti:** Mënyra se si transportohet personi mund të jetë tregues i tregtisë me njerëz; për shembull, nëse fëmijët transportohen nga ndonjë person që nuk është anëtar i familjes ose nëse vajzat e reja janë rekrutuar dhe transportohen për punësim në një qytet ose shtet tjetër. Kjo duhet të nxisë pyetje shtesë, në mënyrë që të eliminohet tregtia potenciale me njerëz.

*Indikatorët lidhur me sjelljen e viktimës potenciale ose të supozuar të TNJ, gjatë kontaktit me personat zyrtarë:*

- personi frikohet të flasë,
- ka mosbesim ndaj organeve të pushtetit dhe refuzon që të bashkëpunojë,
- personi është i udhëzuar se si të flasë,
- jep informata të kundërta, jo të plota dhe të pasakta,
- mundohet të ikë,

- personi rri anash dhe ndahet nga grupi, që tregon se natyrshëm nuk është pjesë e grupit,
- mendon se është i monitoruar dhe i ndjekur,
- lejon të tjerët të flasin në emër të tij/saj,
- manifeston frikë dhe shqetësim,
- reagon me zemërim, impulsivitet dhe agresion,
- personi ka oscilime të dukshme në sjellje,
- tregon sjellje devijuese,
- ka prani të çorientimit, konfuzionit, fobive dhe sulmeve të panikut,
- personi frikohet që të mos i zbulohet statusi,
- personi shfaq shenja të keqpërdorimit të drogës dhe alkoolit

## Intervista

Duhet të merret parasysh se viktimat e tregtisë me njerëz janë të traumatizuar dhe shumë të frikësuar nga tregtarët me njerëz. Gjatë kontaktit të parë ata nuk kanë besim në askënd, sepse besimi i tyre veçmë është keqpërdorur nga ana e trafikantëve.

Gjatë kontaktit të parë, viktimat mund të jenë:

- të armiqësuar
- të zemëruar
- të frikësuar
- nuk kanë besim
- nuk duan bashkëpunim
- nuk duan ta thonë të vërtetën

Si të veproni me viktimën e supozuar ose potenciale

- Ofroni një ndjenjë sigurie dhe inkurajoni viktimën e supozuar
- Siguroni ndihmë urgjente mjekësore nëse viktimat e supozuar e kërkon atë
- Kujdesuni që viktimës t'i sigurohen nevojat elementare (ushqim, ujë, veshje, mjete higjienike).
- Mos hyni në detaje gjatë intervistës/bisedës me viktimën e supozuar-potenciale. Ajo duhet të bëhet nga ana e personave profesionalë,
- Në koordinim me Mekanizmi Nacional për Udhëzimin e viktimave të

tregtisë me njerëz (MNU), shoqatat e qytetarëve, Njësinë për të luftuar tregtisë me njerëz dhe kontrabandë me imigrantë,

Gjatë intervistës së fëmijëve, rekomandohen këto udhëzime<sup>22</sup>

- Fëmijët – viktima potenciale duhet të merren në pyetje vetëm nga personeli i trajnuar për nevojat dhe të drejtat e posaçme të fëmijëve. Sipas mundësisë, fëmijët duhet të merren në pyetje nga personeli i gjinisë së njëjtë.
- Krijoni një hapësirë përkatëse me moshën, sipas mundësisë le të ketë edhe lodra, libra dhe lojëra.
- Krijoni një afërsi nëpërmjet bisedave të rastit ose duke bërë punë që nuk kanë lidhje me përvojën e tregtisë me njerëz (diskutoni për punë që janë të nivelit të fëmijëve, luani lojëra).
- Ruani atmosferën e thjeshtë dhe joformale (mos krijoni atmosferë të hetimit dhe mos bëni presion për të dhënë përgjigje). Thjesht uluni në dysheme me fëmijën deri sa ai luan, kontaktoni me të në lartësi me shikimin e tij.
- Shfrytëzoni një gjuhë adekuate dhe të afërt me fëmijët (zgjidhni nocione që i shfrytëzojnë fëmijët).
- Sqaroni punët në mënyrë të kuptueshme për fëmijët (merrni parasysh shfrytëzimin e mjeteve ndihmëse vizuale). Pyetjet përshtatni me moshën dhe kapacitetin mental të fëmijës.
- Filloni me pyetje të hapura, duke i mundësuar fëmijës që t'u japë rëndësi kuptimeve. Shmangni pyetjet që aludojnë në ndonjë përgjigje. Për shembull, “A të ka keqpërdorur personi?” dhe parashtroni edhe pyetje më të hapura, si për shembull “Çfarë të bëri ai personi?”.

<sup>22</sup> Doracaku i IOM-it për ndihmë të drejtpërdrejtë të viktimave të tregtisë me njerëz: [http://nacionalnakomisija.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/priracnik\\_za\\_direktna\\_pomosh\\_na\\_zhrtvite\\_na\\_trgovija\\_so\\_lugje.pdf](http://nacionalnakomisija.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/priracnik_za_direktna_pomosh_na_zhrtvite_na_trgovija_so_lugje.pdf)



- Mos insistoni dhe mos bëni presion për të marrë detaje kur ka shenja se fëmija ju ka treguar gjithçka që di. Kini parasysh se fëmija mund të shmangë ndonjë informatë ose të japë përgjigje të cilën e konsideron si të pritshme për personin që e interviston.
- Intervistat, sipas mundësisë, duhet të realizohen në prani të prindit. Nëse kjo nuk është e mundur, duhet të jetë i pranishëm edhe kujdestari ligjor, si për shembull psikologu ose punëtori social, që janë të trajnuar.

Përfundoni intervistën në mënyrë që do ta bindni fëmijën se ka bërë një punë të mirë dhe se personi që e ka intervistuar do të jetë përsëri këtu nëse fëmija ka nevojë të flasë sërish.

# SESIONI III.

## MBROJTJA E VIKTIMAVE TË TREGTISË ME NJERËZ

## Pasojat fizike dhe psikologjike ndaj viktimave

Viktimat e tregtisë me njerëz më së shpeshti përjetojnë trauma të rënda fizike dhe psikike si rezultat i dhunës, përdhunimit, kërcënimeve, varësive dhe mjeteve të tjera që tregtarët i shfrytëzojnë për t'i kontrolluar viktimat e tyre.

“Trauma” nënkupton edhe plagë. Edhe në mjekësi, por edhe në psikologji, ajo u referohet lëndimeve të mëdha fizike ose mentale, përfshi edhe kërcënimet me jetë ose kërcënimet ndaj integritetit fizik.

Procesi i rikuperimit tek të gjithë viktimat është i ngadalshëm dhe për këtë mund të ndikojnë shumë faktorë, si personal – shëndeti fizik dhe mental i personit, bindjet pozitive, po ashtu edhe gjendja materiale dhe përkrahja sociale. Përkrahja sociale ka rëndësi kyçe për rikuperimin dhe tejkalimin e gjendjes së krizës dhe përvojat traumatike, e që kanë të bëjnë me strukturën, kualitetin dhe funksionin e ambientit social të cilit i takon. Rikuperimi në masë të madhe varet nga rrethi, familja, miqtë dhe personat e afërt të cilët i përkrahin. Kur bëhet fjalë për rikuperimin e viktimës, flitet për një proces të gjerë i cili nënkupton rikuperimin e vlerave vitale, përkrahje lidhur me krijimin dhe forcimin e raporteve sociale që kanë për qëllim përkrahjen, inkuadrimin në sistemin arsimor, punësimin dhe në përgjithësi gjithçka që mund të kontribuojë për forcimin ekonomik, si dhe përkrahjen gjatë procesit gjyqësor.

Viktima është qenie njerëzore, e cila nuk është e përkufizuar vetëm si viktimë dhe nuk duhet të gjykohet dhe të nënçmohet.

## Specifikat për fëmijët

Duke marrë parasysh faktin që zhvillimi i mëvonshëm i fëmijës, në masë të konsiderueshme përcaktohet nga arritjet e hershme zhvillimore, dhuna ndaj fëmijës gjatë zhvillimit të hershëm nuk lë vetëm pasoja momentale ndaj funksionimit të tij, por ndikon edhe në zhvillimin e tij të mëvonshëm psikosocial. Është fakt që fëmijëve-viktima të dhunës ose të veprave penale u nevojitet një mbrojtje e posaçme, asistencë dhe përkrahje në pajtim me moshën, pjekurinë dhe nevojat e tyre individuale. Për tejkalimin e gjendjeve, nevojitet

zbatimi i intervenimeve adekuate specifike zhvillimore, rikuperim që do të sigurojë kushte për rritje dhe zhvillim të mëtejshëm të sigurt dhe të duhur të fëmijës.

## Pasojat dhe nevojat fizike

Keqpërdorimi fizik i viktimës përkufizohet si përdorim i qëllimshëm i forcës fizike kundër tyre, që shkakton lëndime ose ekziston probabilitet ta dëmtojë shëndetin, mbijetesën, zhvillimin ose identitetin e tyre. Si rezultat i dhunës, viktimat janë të lënduara dhe vuajnë nga një sërë problemesh shëndetësore fizike, seksuale, reproduktive dhe psikologjike.

Shpeshherë viktimat e tregtisë me njerëz janë të keqpërdorura seksualisht. Keqpërdorimi seksual paraqet inkuadrim në aktivitete seksuale pa pëlqimin e fëmijës ose pa vetëdije në të kuptuarit e tërësishëm të kësaj nga ana e fëmijës.

Keqpërdorimi i fëmijëve përfshin të gjitha format e keqtrajtimit fizik ose emocional, keqpërdorimit seksual, anashkalimit ose veprimeve joserioze, si dhe eksploatimit komercial dhe jo vetëm, që sjell vdekjen, lëndimet e vërteta ose potenciale dhe cenimin e shëndetit të fëmijës, rrezikimin e jetës, zhvillimit dhe dinjitetit në kuadër të raportit që përfshin përgjegjësi, besim dhe fuqi.

Pasojat fizike ndaj shëndetit të viktimës mund të jenë çrregullime mekanike, fizike, funksionale të shëndetit.

Secila viktimë ka nevojë për këshillime të besueshme psiko-sociale ose ndonjë ndihmë tjetër psikologjike, varësisht nga nevojat dhe shkeljet që i ka përjetuar viktima, mbrojtje adekuate shëndetësore (mbrojtje primare shëndetësore, mbrojtje shëndetësore specialistike-konsultuese dhe mbrojtje shëndetësore spitalore); rritje dhe zhvillim adekuat të fëmijët, mirëqenie psikike dhe fizike; imunizim i rregullt dhe kontrollë të rregullta sistematike; mbrojtje stomatologjike; si dhe këshillime për seksualitetin dhe keqpërdorimin e substancave adekuate për moshën.

## Pasojat dhe nevojat psikologjike

Trauma shpeshherë është rezultat i sasisë së madhe të stresit, që e tejkalon aftësinë e njerëzve për t'u ballafaquar ose për t'i integruar emocionet gjatë asaj përvoje. Pasojat psikike janë më të mëdha te viktimat e tregtisë me njerëz. Ato përfshijnë:

- tension, shqetësim dhe ndjenjë dobësie,
- ndjenjë të frikës, turpfit, fajit, vetëmohimit,
- humbje të vetëbesimit, pasiguri,
- ndjenjë të pafuqisë dhe pashpresës, depresionit, ankthit, sulmeve të panikut,
- ideve vetëvrasëse,
- çrregullimi i të fjeturit dhe ushqimit,
- mungesë e tolerancës dhe durimit,
- keqpërdorimi i alkoolit, cigareve, drogës, varësisë nga barërat,
- sjellje destruktive ndaj të tjerëve dhe sjelljes vetëshkatërruese,
- Gjithashtu, vërehen edhe ndryshime të shpeshta në disponim (sjellje agresive ose e tërhequr), urinim në shtrat, kokë dhimbje, dhimbje në tërë trupin, veçanërisht në pjesën e gjenitaleve ose pjesën anale, higjienë e keqe dhe vetëmohim.
- Izolim social si pasojë e mungesës së dashurisë dhe përkrahjes emocionale, mungesë të lidhjes etj.

Për tejkalimin e këtyre gjendjeve mund të veprohet edhe me ndihmë psiko-sociale për uljen e stresit, frikës, çrregullimeve postraumatike nga stresi, forcimin e vetëbesimit dhe krijimin e shkathtësive për vetëqëndrueshmëri, besim në njerëzit dhe institucionet. Këshillim që realizohet gjatë tërë trajtimit psikologjik, deri në rikuperimin e plotë të viktimës. Psikoterapi – për tejkalimin e problemeve dhe çrregullimeve emocionale të personalitetit, forcimin e rezistencës dhe parandalimin e mundësisë që të viktimizohet përsëri.

Karakteristikat psikologjike të viktimës së tregtisë me njerëz shprehen si dëmtime psikologjike të personalitetit dhe reagimet në situatën në të cilën kanë qenë, varen nga përjetimet stresuese dhe traumatike të fëmijërisë dhe periudhës sa ka qenë viktimë. Profili i viktimës mund të përshkruhet në përgjithësi si integritet i cenuar i personalitetit dhe identitet

i humbur – nuk dinë “kush janë e as çfarë janë, e as çfarë presin nga e ardhmja”. E përjetojnë të kaluarën, e dënojnë të tashmen, nuk besojnë në të ardhmen.

### Stresi post-traumatik (PTSD) (sjellja dhe nevojat)

Stresi post-traumatik është pasojë e ekspozimit psikologjik ndaj përjetimeve stresuese, që përfshijnë rreziqe vdekjeprurëse, lëndime serioze fizike ose kërcënime ndaj integritetit fizik të personit, të cilat i përjeton si skajshmërisht traumatike. PTSD është çrregullim që mund të zhvillohet tek njerëzit pas përjetimit të ndonjë traume. Viktimat e tregtisë me njerëz shpeshherë i kanë simptomat e sindromit postraumatik, që në veçanti janë të pranishme të ashtuquajturit “fleshbek” (flashback) – përvojat e shpeshta, të shqisave të cilat shpeshherë përfshijnë kujtime vizuale, auditive, të faktorit dhe taktile, të aktit të dhunës, sikurse po ndodh në të tashmen, e jo sikur ato janë kujtime nga e kaluara.

Simptomat e PTSD janë përgjigje e trupit që shkaktohet nga stresi. Në zhvillimit të stresit psikotraumatik mund të ndikojnë shumë faktorë psikologjik, gjenetik, fizik dhe social. Ekzistimi i traumave psikike që veçmë janë përjetuar gjatë jetës së një personi, mund të shkaktojë një rrezik të rritur të paraqitjes së stresit post-traumatik pas përjetimit të situatave stresuese.

Çrregullimet stresuese post-traumatike, para se gjithash, kanë të bëjnë me: përjetimin e shpeshtë të ndodhive nëpërmjet maktheve dhe mendimeve të ngulitura, shmangien e stimuljeve që përkujtojnë traumat dhe problemet me fjetjen, përqendrimi i keq, anksoziteti, mendimet vetëvrasëse dhe depresioni.

## Shenjat dhe simptomat e PTSD

Shenjat dhe simptomat e PTSD janë dukuritë që manifestohen në organizmin e personit të traumatizuar, që shkaktohen nga kombinimet e ndryshme të faktorëve fizik dhe psikologjik, por që më së shumti janë:

Shkaktuesit	Shenjat dhe simptomat
Përjetimi i serishëm i ndodhisë	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Shqetësimi dhe përsëritja e momenteve të vështira</li> <li>➤ Ndjenjë e befasisë sikur që rasti traumatik të ndodh përsëri (flashback).</li> <li>➤ Përsëritja e ëndrrave të makthit lidhur me ngjarjen</li> </ul>
Ndjeshmëria e rritur psikike dhe shqetësimi i theksuar	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Vështirësi për të fjetur dhe gjumë të qetë</li> <li>➤ Nervozë ose sulme të inatit dhe zemërimit</li> <li>➤ Aftësi të rënuara për përqendrim</li> <li>➤ Reagim me frikë të tepruar</li> <li>➤ Pritja e shqetësimeve të reja</li> </ul>
Shmangia e situatave dhe rrethanave që i përkujtojnë ose kanë lidhje me ngjarjet traumatike	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Tentativa për të shmangur mendimet dhe ndjenjat lidhur me traumën</li> <li>➤ Pamundësia për të kujtuar ndonjë pjesë të rëndësishme të traumës</li> <li>➤ Ndjenja se nuk ka të ardhme për ta (p.sh. personi nuk pret se mund të ketë karrierë, martesë, fëmijë ose një jetë tjetër)</li> <li>➤ Interes i ulur për aktivitetet me rëndësi jetike</li> <li>➤ Ndjenjë të ndarjes ose largimit nga të tjerët</li> <li>➤ Mërzi emocionale (p.sh. paaftësi për ndjenja dashurie)</li> <li>➤ Tentativa për të shmangur aktivitetet ose situatat të cilat i kujtojnë traumën</li> </ul>

Për tejkalimin e stresit post-traumatik mund të zbatohen lloje specifike të psikoterapisë së fokusuar ndaj traumës, shërim psikiatrik dhe terapi adekuate me medikamente, përkrahje dhe këshillime individuale dhe grupore, programe psiko-edukative për ndihmë dhe përkrahje. Disa prej problemeve mund të trajtohen me ndihmën e terapisë grupore, por pjesa më e madhe e viktimave (veçanërisht viktimat me probleme të thella psikike) e kanë të domosdoshme qasjen dhe terapinë individuale.



## **Sigurimi i ndihmës dhe përkrahjes për viktimat e tregtisë me njerëz**

**Të gjitha viktimat potenciale dhe të identifikuar të tregtisë me njerëz që do të hasen në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut duhet të marrin ndihmë dhe përkrahje.**

Ndihma dhe përkrahja e viktimave të tregtisë me njerëz realizohet sipas Procedurave Standarde Operative të cilat e mbulojnë secilin segment të procesit, që nga momenti i identifikimit e deri në kthimin dhe risocializimin e tyre.

### **Akomodimi i sigurt**

Me vetë zbulimin e viktimës dhe fillimin e procesit të identifikimit filon edhe ndihma e përkrahja. Para së gjithash, viktimata akomodohet në një vend të sigurt ku do të ndihet e sigurt dhe e mbrojtur. Menjëherë përmbushen nevojat elementare si ushqimi, veshja, mjetet e higjienës personale. Bëhet vlerësimi i gjendjes shëndetësore dhe ofrohet ndihma mjekësore.

Në RMV ekzistojnë dy qendra për akomodimin e viktimave të tregtisë me njerëz. Varësisht nga prejardhja e viktimave ato mund të dërgohen për strehim në qendrat për viktimat e tregtisë me njerëz që është e dedikuar për shtetas të Maqedonisë së Veriut dhe të huajt që kanë qëndrim të rregulluar, si dhe në Qendrën e strehimit për të huajt, nëse viktimat janë shtetas të huaj dhe nuk kanë qëndrim të rregulluar.

## Informimi i viktimave

Pas akomodimit dhe përmbushjes së nevojave elementare, pason informimi dhe orientimi i viktimave. Ju jepen informata që do t'ua qartësojnë viktimave se ku gjenden, çfarë shërbime dhe programe kanë në dispozicion, cilat janë të drejtat dhe obligimet e tyre. Informatat u jepen në gjuhë të kuptueshme për viktimën.

Viktimat që janë shtetas të huaj në mënyrë shtesë informohen për dispozitat ligjore që rregullojnë: të drejtën e qëndrimit të përkohshëm, procedurat e kthimit në vendin e origjinës, sigurimin e dokumenteve dhe kontaktin me zyrat konsullore të vendit amë në RMV.

Të gjitha informatat barten me gojë, por gjithashtu edhe në formë të shkruar nëpërmjet fletushkave dhe materialeve tjera informative, të shkruara në gjuhë të kuptueshme për viktimën.

Pasi që viktima është informuar, jep pëlqimin për pranimin e programit për ndihmë dhe përkrahje.

## Pëlqimi për pranimin e programit për ndihmë dhe përkrahje

**Viktima duhet të japë PËLQIM për realizimin e ndihmës, se e pranon ofertën për ndihmë, kushtet dhe afatet e caktuara, të cilat paraprakisht janë sqaruar në gjuhën që e kupton viktima. Nëse bëhet fjalë për fëmijë viktimë, pëlqimi jepet nga prindi ose kujdestari. Pëlqimi duhet të jepet në formë të shkruar.**

## Vlerësimi i nevojave

Nevojat individuale të viktimës identifikohen gjatë një bisede individuale ndërmjet udhëheqësit të rastit dhe viktimës (edhe me kujdestarin, nëse bëhet fjalë për fëmijë). Merret parasysh gjendja shëndetësore, respektivisht gjendja fizike dhe mentale e viktimës.

Pas akomodimit të personit, bëhet vlerësimi i nevojave specifike/individuale dhe një vlerësim i rrezikut të përgjithshëm ndaj të cilit është ekspozuar: nevoja për strehim adekuat, mbrojtje shëndetësore, arsimim dhe ndihmë juridike. Bëhet vlerësimi i funksionimit të pavarur (sjellja psikike, mendore, emocionale dhe funksionale), vlerësimi i përkrahjes joformale nga rrjeti social (familja, të afërmit, miqtë), si dhe të sistemeve që mund të ofrojnë shërbime. (Aneksi 1)

### SI BISEDOHET ME NJË FËMIJË GJATË VLERËSIMIT TË NEVOJAVE?

Gjatë vlerësimit të nevojave të fëmijës viktimë, patjetër duhet të jetë prezent edhe prindi ose kujdestari i fëmijës, udhëheqësi i rastit dhe personi profesional i Qendrës, por edhe përkthyesi sipas nevojës. Biseda realizohet në një nivel të kuptueshëm për fëmijën. Qartësohen nocionet, bëhen parafrazime me qëllim që të konfirmohet se fëmija e ka kuptuar përmbajtjen e bisedës si dhe gjendjen në të cilën gjendet. Nuk shfrytëzohen nocione profesionale dhe varësisht nga moshja dhe aftësia intelektuale e fëmijës, mund të shfrytëzohen edhe teknika të ndryshme për sqarimin e situatës.

## Plani individual i trajtimit

Plani individual i trajtimit përpilohet në bazë të një vlerësimi të realizuar të nevojave të viktimës. Plani përpilohet në bashkëpunim dhe me pjesëmarrje të viktimës dhe (prindit/kujdestarit nëse bëhet fjalë për fëmijë), detyrimisht përfshin edhe persona të Qendrës për punë sociale si dhe persona profesional nga Qendra e viktimave. Plani patjetër duhet të ketë konkret dhe i qartë dhe t'i përfshijë të gjitha nevojat e individuale

të identifikuar të viktimës. Në detaje përshkruhen hapat për kujdesin e viktimës në kuadër të Qendrës por edhe jashtë saj. Nënvizohen obligimet e ekipit profesional si dhe obligimet e viktimës.

Në këtë plan, detyrimisht përfshihet edhe procesi i adaptimit dhe stabilizimit, lidhja me familjen dhe përgatitja për risocializim (kthimin në shoqëri). Bëhet vlerësimi i kapaciteteve personale të viktimës, ambientit social (gjendjes familjare dhe kushtet e familjes së ngushtë dhe asaj të gjerë), rrethit dhe komunitetit lokal (institucioneve arsimore, shëndetësore dhe sociale, shoqata të qytetarëve etj.).

Gjatë tërë procesit të realizimit të planit ndiqet përparimi i viktimës dhe në varësi të shkallës së realizimit dhe gjendjes së viktimës, ai mund t'i nënshtrohet rishqyrtimit dhe azhurnimit, duke marrë parasysh nevojat e sapo shkaktuara dhe plotësuese. (Aneksi 2)

## **Adaptimi dhe stabilizimi**

Procesi i adaptimit dhe stabilizimit nënkupton një qasje multisektoriale dhe realizohet me inkuadrimin e udhëheqësit të rastit, personit përgjegjës të QPS/IMN, Organet kompetente, ekip mobil, punëtorë shëndetësorë dhe arsimorë, shoqata të qytetarëve, vetëqeverisja lokale, si dhe faktorë të tjerë.

Ky proces zgjat një periudhë më të gjatë kohore, respektivisht 3 muaj me mundësi vazhdimi për edhe 3 muaj të tjerë dhe është në funksion të përshtatjes në ambientin dhe situatën e re, si dhe për tejkalimin e vështirësive me të cilat është ballafaquar viktimat.

Gjatë kësaj periudhe viktimat ka në dispozicion shërbime të cilat përfshijnë:

- ✎ pako me shërbime të nevojshme shëndetësore dhe ndihmë mjekësore për avancimin e shëndetit fizik dhe mendor;

- ndihmë dhe përkrahje psiko-sociale ku përfshihet ndihma psikologjike individuale me qëllim të tejkalimit të traumës dhe kthimit të vetëbesimit;
- mundësi për edukim/trajnim për të përvetësuar njohuri, shkathtësi dhe zeje, arsim të rregullt për fëmijët, aktivitete socio-edukative dhe terapi pune që synojnë rritjen e ndjenjës së pavarësisë dhe ndërtimit të aftësive për menaxhimin e kohës;
- mundësi për kontakt me familjen nëpërmjet telefonit ose ngjashëm (nëse familja nuk është e përfshirë në rast), planifikimin e vizitës së familjes deri sa është në Qendër gjatë një kohe të caktuar, pas vlerësimit paraprak të sigurisë me qëllim të ruajtjes dhe forcimit të lidhjeve me familjen;
- ndihmë juridike, planifikim të intervistës, transport të sigurt dhe siguri kur shkon në polici ose prokurori, në mënyrë që të rritet ndjenja e drejtësisë nëpërmjet kontributit personal për të ndihmuar drejtësinë dhe dënimin e kryerësve.
- Përgatitja për riintegrimin dhe risocializimin në drejtim të përfshirjes me sukses në shoqëri si një qytetar i barabartë.
- Përkrahja e personave që kanë nevojë për qëndrim më të gjatë në Qendër dhe/ose duan të kthehen në shtëpi pas skadimit të kohës për adaptim dhe stabilizim.

Për ndjekjen dhe vlerësimin e avancimit të viktimës gjatë procesit të stabilizimit, të gjitha palët e interesuara kanë takime të rregullta ekipore. Gjatë këtyre takimeve përpilohet raport për avancimin e viktimës dhe informohen për rezultatin nga vlerësimi i ekipit.

# SHËRBIMET PËR VIKTIMAT E TREGTISË ME NJERËZ

## Ndihma mjekësore

Shëndeti i viktimave ka rëndësi primare gjatë procesit të mbrojtjes. Për të gjitha viktimat potenciale dhe të identifikuar, sigurohet qasje për ndihmë mjekësore e cila përfshin kontrolle të rregullta mjekësore për gjendjet akute dhe kronike, shërbime dhe analiza laboratorike, teste për Kovid-19, HIV/Sidë dhe hepatit, kontrolle dhe intervenime gjinekologjike, kontrolle dhe terapi psikiatrike, kontrolle dhe intervenime stomatologjike, si dhe shërbime tjera të nevojshme nga institucionet shëndetësore. Kontrollet mund të realizohen në institucione shëndetësore private ose shtetërore, varësisht nga fakti nëse viktima ka sigurim shëndetësor dhe ka termin për kontrollet e nevojshme.

52

Në kuadër të aktiviteteve të rregullta në qendrat e viktimave, personat profesional duhet të realizojnë punëtori për edukim shëndetësor. Ky edukim duhet të jetë në aspekt të temave për sëmundje ngjitëse seksuale, shprehi të jetës, higjienës personale, sëmundje kronike etj., me çka do të rritet niveli i kujdesit për veten dhe shëndetin personal të viktimave.

## Ndihma dhe këshillimi i specializuar psiko-social

Traumat që kanë përjetuar kanë lënë plagë të thella dhe kanë dëmtuar rëndë shëndetin mendor të viktimave. Për më tepër, lidhjet e tyre sociale janë prishur ose ndërprerë. Prej këtu lind nevoja për asistencë dhe këshillim të vazhdueshëm psiko-social për çdo viktima të mundshme të tregtisë me njerëz.

Kjo mbështetje përfshin lloje të ndryshme trajtimesh dhe seancash, terapi në grup dhe këshillim individual. Këshillimi rekomandohet të jetë i vazhdueshëm, dhe në rast nevojë për ndihmë urgjente dhe më intensive, një psikoterapist ose psikiatër përfshihet në ofrimin e mbështetjes dhe këshillimit.

Personat nga ekipi i ekspertëve për ndihmë psiko-sociale për viktimat duhet të mbajnë shënime për çdo rast individual. Ata duhet të kryejnë punë të drejtpërdrejtë këshilluese dhe terapeutike me viktimat, të zhvillojnë bashkëpunim me organizata dhe institucione tjera lidhur me rastin, të monitorojnë procesin e rehabilitimit, të mbajnë kontakte me Qendrat për Punë Sociale dhe të ofrojnë lidhje me familjet. Ekipi gjithashtu duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë informimit të viktimave dhe inkurajimit të tyre për të drejtën e përdorimit të shërbimeve në dispozicion të ofruara nga shteti. Ekipi gjithashtu duhet të ndihmojë në vendosjen e kontakteve me institucionet përkatëse për marrjen e dokumenteve personale për viktimat.

### **Këshillimi juridik**

Trafikimi i qenieve njerëzore është një krim që cenon të drejtat themelore të njeriut. Viktimat e trafikimit kanë të drejtën e ndihmës juridike falas në formën e këshillimit dhe përfaqësimit në procedimet penale, kur ato paraqiten si palë të dëmtuara ose dëshmitarë.

Këshillimi ligjor dhe përfaqësimi i viktimave nga tregtia me njerëz mundësohet duke punësuar avokat me përvojë shumëvjeçare në këtë çështje, të cilët janë të njohur me zhvillimet dhe përpjekjet aktuale për të trajtuar këtë dukuri në vend. Është veçanërisht e rëndësishme të theksohet momenti psikologjik lidhur me procesin e dëshmisë. Prandaj, është e rëndësishme t'i kushtohet vëmendje e veçantë përgatitjes së viktimave për gjykim. Vendimi për të bashkëpunuar me organet gjyqësore dhe ligjzbatuese ndikohet shumë nga frika e përballjes me të pandehurit, frika nga kontaktet me autoritetet gjyqësore dhe frika të ngjashme. Shpesh, viktimat fillimisht nuk duan të përballen me këtë frikë dhe refuzojnë të bashkëpunojnë. Është e rëndësishme t'i shpjegohet viktimës se cilat janë aspektet pozitive dhe cilat janë përfitimet e pjesëmarrjes në procedurë.

Çelësi për tejkalimin e këtyre frikave janë këshillimi intensiv nga ekipi i ekspertëve të Qendrës dhe një avokat që e shoqërojnë më tej viktimën gjatë gjykimit.

## Arsimimi dhe kualifikimet profesionale shtesë

Në RMV, arsimi fillor dhe i mesëm janë të obligueshëm dhe secili fëmijë ka të drejtë për arsimim falas. Viktima e tregtisë me njerëz, për shkak të formës së eksploatimit, varësisht nga mosha, shpeshherë është e detyruar ta braktisë shkollën. Pasi që do të identifikohet dhe strehohet, gjatë gazës së vlerësimit të nevojave përcaktohet dhe shënohet shkalla e arsimimit. Në planin individual të trajtimit, në mënyrë të detyrueshme inkorporohet edhe arsimimi që duhet të vazhdojë aty ku viktima e ka ndërpreur. Shqyrtohen të gjitha mundësitë për kthimin e saj në sistemin e arsimit formal. Nëse mosha e viktimës e tejkalon moshën e caktuar për arsimim të rregullt, atëherë ajo dërgohet në shkolla që mundësojnë arsimim të çrregullt. Gjatë kthimit në sistemin arsimor, viktimave u jepet përkrahje për të përfunduar arsimin formal. Ata në mënyrë aktive inkurajohen ta kompletojnë arsimimin e tyre, ndërsa ekipi profesional i Qendrës u ndihmon që të zotërojnë materialin e dhënë nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme.

54

Në mënyrë shtesë, në periudhën e adaptimit dhe risocializimit rekomandohet të organizohen edhe kurse zejtarie dhe programe të tjera profesionale për kualifikim.

Këto programe plotësuese planifikohen dhe realizohen në marrëveshje me viktimën në bazë të kapaciteteve dhe interesave të saj. Aktivitetet plotësuese për arsimim profesional të viktimës janë të organizuara për të rritur njohuritë dhe aftësitë e tyre, rritjen e konkurrencës në tregun e punës, fuqizimit ekonomik të viktimave, ndërtimin e vetëbesimit dhe vetë respektit.

Trajnimet/shërbimet që janë në dispozicion të viktimave përzgjidhen varësisht nga nevojat dhe interesat e tyre, siç janë:

- Kurse për shkathtësi zejtarie, punë me kompjuterë, mësimin e gjuhëve të huaja etj.
- Trajnime për të shkruar biografi të shkurtë, plotësimin e fletëparaqit-



jeve për punë, shkrimin e letrave motivuese, përgatitjen e dokumenteve, komunikimet gjatë intervistave të punës.

- Sigurimin e ndihmës gjatë kërkimit të punës dhe qasje deri te informatat dhe shërbimet (si të informohen për shpalljet e sigurta për punë dhe mundësi të tjera për punësim).
- Bashkëpunim me agjenci dhe institucione të punësimit.

## Inkuadrimi i familjes/ bashkimit të sërishëm

Lidhjet dhe rrjetet e shëndosha familjare të përkrahjes janë shumë të rëndësishme në procesin e rikuperimit të viktimave. Për t'i ruajtur këto lidhje të shëndosha shëndetësore vendoset një kontakt me anëtarët e familjeve të viktimave dhe paralelisht punohet edhe me to. Në rast të mungesës së familjes, inkuadrohen persona të tjerë të afërt, me cka krijohet mundësi për një lidhje të shëndoshë. Lidhjet krijohen nëpërmjet qendrave të punës sociale ose drejtpërdrejtë nëse viktimat është e rritur dhe insiston të ketë kontrakt të drejtpërdrejtë. Familja duhet të përgatitet që ta pranojë viktimën dhe t'i japë përkrahje.

Ka raste kur viktimat nuk mund të kthehet në familje nga se një anëtar i familjes ka qenë i involvuar në tregtimin e viktimës ose familja nuk dëshiron ta pranojë viktimën mbrapa. Nëse viktimat është e moshës së rritur, ajo mund të vendosë vetë se ku do të vazhdojë të jetojë pas lëshimit të Qendrës. Nëse viktimat është person i mitur, kërkohen familjarë të afërt ose familje për përkujdesje që mund ta pranojnë viktimën. Vendoset kontakt edhe me familjet, nëpërmjet qendrave të punës sociale ose shoqatave të qytetarëve dhe punohet edhe nëpërmjet këshillave që të pranohet viktimat duke u munduar vazhdimisht në përgatitjen e familjes ta pranojë viktimën.

# SESIONI IV.

## RISOCIALIZIMI DHE RIINTEGRIMI

Risocializimi shfrytëzohet si nocion në kuptimin më të gjerë, që paraqet kthimin e viktimës në komunitetin e shoqërisë dhe aftësimin e saj që të jetojë në përputhje me jetën shoqërore. Të kryejë në mënyrë normale dhe me sukses veprimtaritë shoqërore sepse viktimat në procesin e socializimit dhe gjatë zhvillimit dhe maturimit të personalitetit ka paraqitur sjellje të mospërshtatjes për shkak të faktorëve të ndryshëm të pavolitshëm. Për këtë ekziston nevojë për risocializimin e tyre shtesë dhe të sërishëm.

Riintegrimi mund të kuptohet si ripërtëritje ose plotësim shtesë të gjërave që kanë qenë shumë të rëndësishme për individin ose që i kanë munguar, e që ka pasur ndikim kyç për shkaktimin e dukurisë së padëshiruar. Riintegrimi paraqet një proces gjithëpërfshirës, i cili është i përshtatur për shmangien e arsyeve të tregtisë me njerëz. Ndryshimet e shkaktuara te personi, familja dhe komuniteti lokal janë parakusht kryesor për riintegrimin e suksesshëm. Nëse bëjmë ndryshime vetëm në një nivel, për shembull te personaliteti, ndërsa nuk i shohim ndryshimet nëpër nivelet e tjera, ekziston mundësi e konsiderueshme që viktimat përsëri të rrezikohet duke e vështirësuar mundësinë e riintegritimit.

Ky është dallimi më i rëndësishëm ndërmjet risocializimit dhe riintegritimit. Risocializimi insiston që të ketë ndryshime në nivel të individit, ndërsa riintegrimi nënkupton ndryshime të domosdoshme në të gjitha nivelet.

Qëllimi i përbashkët i risocializimit dhe riintegritimit është që viktimat e tregtisë me njerëz të përgatitet sërish për integrim të sërishëm në mjedis dhe inkuadrim të saj të suksesshëm brenda komunitetit. Krahas qëllimit të përbashkët, secili prej këtyre proceseve ka edhe karakteristikat e veta specifike dhe realizohen në periudha të ndryshme dhe ambiente të ndryshme. Risocializimi ka për qëllim ta rehabilitojë viktimën dhe ta përgatit për riintegrimin e suksesshëm në komunitetin/ambientin e mëparshëm ose në atë të ri dhe realizohet gjatë qëndrimit të viktimës në QV/QSH, si dhe në ambientin në të cilën viktimat kthehet pas lëshimit të QV/QSH.

Viktimat që nuk qëndrojnë në QV, programin e risocializimit e realizojnë në vendin e tyre të jetesës. Periudha e risocializimit dhe riintegritimit është një proces afatgjatë, i cili përfundon kur viktimat e tregtisë me njerëz në tërësi do të integrohet në ambient dhe do të bëhet anëtar më aktiv në shoqëri në jetën ekonomike, kulturore, qytetare dhe politike, si dhe në jetën e përditshme do të funksionojë duke ndërtuar marrëdhënie stabile me personat e rrejtës të tyre social, duke u bazuar në respektin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë.

Procesi i risocializimit përfshin shërbime në sferat: Akomodim-banim i sigurt; Këshillime psikologjike; Mbrojtje shëndetësore; Ndihmë juridike.

Procesi i riintegritimit përfshin shërbime në sferat: Transport; Kthim i sigurt në familje dhe në format e tjera alternative; Mbrojtja sociale dhe femijërore; Arsim dhe Punësim.

## Përgatitje për risocializim dhe riintegrim

Masat për ndihmë që merren gjatë procesit të risocializimit përfshijnë shërbime dhe aktivitete për përkrahjen e viktimës gjatë qëndrimit në QV, si dhe në procesin e riintegritimit në komunitet ose familje pas kthimit të tyre.

Për viktimat e huaja, realizimi i masave për risocializim realizohen gjatë qëndrimit të viktimës në Qendrën e strehimit për të huajt. Risocializimi, si dhe përgatitja për risocializim, fillon menjëherë pasi që viktima do të përkujdeset në QV ose në Qendrën e strehimit për të huajt, ose menjëherë pas periudhës së reflektimit. Për viktimat e huaja, procesi i risocializimit është në dispozicion deri në kohën e largimit të tyre, kur jepen rekomandime për vazhdimin e këtij procesi edhe pas kthimit të tyre në vendin e origjinës.

## Udhëzimet për vazhdimin e riintegrit

Viktima nga vendi përgatitet për inkuadrim aktiv në jetën shoqërore gjatë tërë qëndrimit në Qendrën e viktimave të tregtisë me njerëz, respektivisht para se të kthehet në vendbanimin e vet ose në vendin alternativ të sigurt për qëndrim, ku planifikohet integrimi i viktimës. Jepen rekomandime për komunitetin ku kthehet, për ta pranuar, nëse është fëmijë edhe që të inkuadrohet në procesin arsimor, për të cilën bisedohet me institucionin arsimor lidhur me cenueshmërinë e tij. Ofrohen edhe kontaktet e institucioneve kompetente, të shoqatave të qytetarëve në mënyrë që vazhdimisht të monitorohet integrimi i viktimës. Gjithashtu, edhe vetë viktima ka kontakte për komunikim me institucionet ose shoqatat e qytetarëve për çdo ndihmë të nevojshme gjatë miratimit të ndonjë vendimi të rëndësishëm për jetën e tyre, vështirësive të caktuara brenda komunitetit, etj.

Risocializimi dhe riintegrimi realizohet në bazë të programeve dhe planeve individuale ekzistuese, të krijuara në bashkëpunim me viktimën, sipas nevojave dhe aftësive të secilës prej tyre në veçanti, duke praktikuar: Programin për ndihmë dhe përkrahje gjatë riintegrit të viktimave të tregtisë me njerëz dhe Programin për ndihmë dhe përkrahje gjatë riintegrit të fëmijëve viktima të tregtisë me njerëz.

Në procesin e risocializimit dhe riintegrit të fëmijës, në mënyrë aktive inkuadrohet edhe prindi ose kujdestari, ose personat tjerë të përkujdesjes, siç janë familjet kujdestare dhe personeli i shtëpive të grupeve të vogla.

Për viktimën e huaj të strehuar në Qendrën e strehimit për të huajt, në fazën e përgatitjes së riintegrit inkuadrohen edhe personat përgjegjës (punëtori social/psikologu) nga Qendra e strehimit për të huajt, së bashku me personin përgjegjës të rastit në bashkëpunim me punëtorin social dhe psikologun nga QV (nëse ka qenë e strehuar gjatë periudhës së reflektimit). Personi përgjegjës i rastit është i obliguar me viktimën që nga momenti i identifikimit të viktimës, e deri në përfundimin e procesit të risocializimit dhe riintegrit.

## Plani i risocializimit dhe riintegritimit

Planet e risocializimit dhe riintegritimit përgatiten për secilën viktimë në veçanti. Plani individual duhet të bazohet në nevojat, mundësitë dhe interesat e viktimës, ndërsa përgatitet nga ana e personit përgjegjës në bashkëpunim me ekipin për përkrahje. Plani është fleksibil dhe sipas nevojës mund të ndryshohet dhe plotësohet. Plani përpilohet menjëherë pas vlerësimit të bërë të viktimës nga ana e ekipit profesional të QPS dhe shoqatave të qytetarëve. Plani i risocializimit parasheh: Përkrahje psiko-sociale; Aktivitete për stabilizim dhe vetë forcim; Ndhimë juridike; Aktivitete sociale; Aktivitete sportive ose përkrahje për plotësimin kreativ të kohës së lirë.

Plani i riintegritimit parasheh: Përgatitjen e ambientit (familjes, familjes kujdestare, personelit dhe fëmijëve nga shtëpitë e vogla grupore), për kthimin/përkujdesjen e viktimës; Vazhdimin e arsimimit; Trajimet për aktivitete; Këshillime dhe ndihmë gjatë punësimit.

62

Për viktimat vendase që nuk janë strehuar në QV – plani i risocializimit përpilohet menjëherë pas vlerësimit të nevojave të viktimës nga ana e ekipit profesional të QPS kompetente.

Për viktimat e strehuara në QV, plani i risocializimit përpunohet pas strehimit të tyre në QV në bashkëpunim me QPS, ekipit profesional të Qendrës dhe familjes, duke krijuar planin për riintegrim në komunitet, dhjetë ditë para lëshimit të QV.

Për viktimat e huaja të strehuara në Qendrën e Strehimit për të Huajt, plani i risocializimit përpilohet menjëherë pas përkujdesjes, nga personi përgjegjës, ekipi profesional dhe punëtori social me psikologun e QPH.

Në rastet kur kemi fëmijë të huaj-viktima të TNJ, krijohen relacione nëpërmjet MTU kontaktet në vendin e origjinës ose nëpërmjet procedurave tjera formale, ku rëndësi ka që të fillojë procesi i juridikcionit ndaj familjës, si dhe të krijojë një plan për risocializimin e tij, që përgatitet menjëherë pas përkujdesjes së tij në QPH nga ana e personit përgjegjës, ekip-



it profesional dhe psikologut me punëtorin social në QPH. Plani i risocializimit dhe riintegritit për fëmijë është i detyrueshëm dhe rekomandohet për realizimin e masave afatgjate dhe inkuadrimit në institucionet arsimore. Procesi i risocializimit është në dispozicion deri në largimin e tyre nga QPH/QV, me rekomandim për vazhdimin e këtij procesi edhe pas kthimit të tyre në vendin e origjinës.

Plani i risocializimit dhe riintegritit duhet të zhvillohet së bashku edhe me pëlqim të viktimës në mënyrë që të fitohet ndihmë shtesë. Nëse viktima nuk dëshiron të përfshihet në Programin e risocializimit dhe riintegritit, do t'i ofrohen informata për institucionet dhe organizatat e caktuara të cilave mund t'u drejtohet në mënyrë plotësuese, sipas nevojës.

Viktima mund të parashtrojë ankesë deri te personi përgjegjës i rastit për t'i shprehur vërejtjet lidhur me cilësinë e shërbimeve dhe procedurave të ofruara. Ankesa mund të parashtrohet gojarisht ose në formë të shkruar. Nëse viktima nuk është e kënaqur me personin përgjegjës, mund të parashtrojë ankesë deri te MNU/ose deri te Komisioni nacional për luftimin e tregtisë me njerëz dhe migrim ilegal. Secili prej ofruesve të shërbimeve në rolin e personit përgjegjës të rastit (nëse ankesa nuk është kundër tij) është i obliguar që të shqyrtojë supozimet e ankesës në afat sa më të shkurtë kohor dhe ta njoftojë viktimën. Parashtrimi i ankesës, në asnjë rast nuk duhet të ndikojë negativisht në ofrimin e shërbimeve ndaj viktimës.

## Kthimi i sigurt

Procesi i kthimit duhet të jetë vullnetar, me dinjitet dhe i sigurt, ku do të përfshihet përgatitja, transportimi dhe pranimi i viktimës në vendin e origjinës ose në vende të treta. Viktimave duhet t'u jepen mundësi që të prononcohen nëse, kur dhe si do të donin që të kthehen në shtëpi.

Për viktimat vendase të tregtisë me njerëz, kompetent për kthimin e tyre janë MNU/QPS, në bashkëpunim me koordinimin e NJTNJKI/NJNLKI pranë MPB-së, ekipet mobile dhe SHV.

Mundësia për kthim është në familje apo familjet e përkujdesit nëse bëhet fjalë për fëmijë, akomodime të tjera alternative si p.sh. shtëpi të vogla grupore. Vetë kthimi realizohet nëpërmjet marrjes së personit nga Qendra e viktimave nga ana e personit të autorizuar i cili e transporton dhe e dorëzon deri në lokacionin e nevojshëm të një person që duhet ta marrë, sipas planit të bërë paraprakisht. Transportimi i viktimës nga QP deri në vendbanimin e tij, duhet të jetë i sigurt dhe i siguruar për viktimën.

Për viktimat – shtetas të huaj, shfrytëzohet Mekanizmi Transnacional për Udhëzim, nëse ekziston në vendet e prejardhjes ose nëpërmjet formave zyrtare të komunikimit. Organet kompetente në kuadër të institucioneve janë MPB/NJTNJKI/NJNLKI, MPPS/MNU/QPS (në rastet me fëmijë) dhe MPJ; në raste të caktuara gjatë procesit të kthimit inkuadrohen edhe organizatat ndërkombëtare dhe shoqatat e qytetarëve.

Transportimi i viktimës nga QPH/QV deri në vendbanimin e tyre, respektivisht vendin e origjinës, duhet të jetë i sigurt dhe i siguruar për viktimën

Fëmija-i huaj nuk guxon të kthehet në vendin e origjinës ose në një shtet të tretë, që dakordohet ta pranojë, deri sa ai shtet nuk bën vlerësimin e familjes ose insitucionit që do ta pranonte, si dhe deri sa të sigurohen kushte adekuate për pranimin e tij. Deri sa të krijohen kushtet adekuate, fëmija duhet të qëndrojë në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Viktima vetë sjell vendim të informuar për kthimin e tij. Deri sa të vendosë, mund që të konsultohet me institucionet kompetente dhe shoqatat e qytetarëve.

Për kthimin e fëmijës së huaj, kompetent është QPS në bashkëpunim me NJTNJKI/NJNLKI pranë MPB-së.

## Vlerësimi i rreziqeve dhe mundësive për inkuadrim social

Vlerësimi i rrezikut dhe sigurisë përpara kthimit ka rëndësi të konsiderueshme në garantimin e sigurisë së viktimës dhe të familjes së saj. Kjo bëhet menjëherë pasi që viktima të ketë vendosur të kthehet në shtëpi.

Vlerësimi për kthimin e sigurt e bën personi përgjegjës i rastit, në bazë të informatave të marra nga: Viktima; MNU/QPS pranë MPPS, Ekipet mobile dhe NJTNJKI/NJNLKI pranë MPB-së; Personat përgjegjës nga MTU nga vendi i origjinës nëse ka, si dhe kontakte të tjera të vendosura; SHV; Ministria e Punëve të Jashtme – Përfaqësitë diplomatike konsullore (PDK të vendit të origjinës dhe PDK të RMV-së për viktimat vendase që identifikohen jashtë vendit); Organizatat ndërkombëtare. Vlerësimi dorëzohet deri te personi përgjegjës i rastit, i cili e informon viktimën për rezultatet.

Fëmija nuk guxon që të kthehet nëse kthimi i tij është në kundërshtim me Konventën për të drejtat e fëmijës, Konventën për statusin e refugjatëve, si dhe Protokollin dhe Konventën evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore.

## Zhvillimi i planit për menaxhimin e rreziqeve

Në bazë të vlerësimit të bërë të rrezikut dhe sigurisë, si dhe vlerësimin e inkuadrimin social të viktimës, zhvillohet plani për menaxhimin e rrezikut, me qëllim që i njëjti të jetë minimal dhe të menaxhohet më lehtë.

Vlerësimi i rrezikut gjatë inkuadrimin social të fëmijës bëhet në konsultim me prindin ose kujdestarin. Bashkëpunimi ndërmjet personave përgjegjës në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe institucionet/organizatat kompetente nga vendi i origjinës zhvillohet në pajtim me ligjet ekzistuese me qëllim që të sigurohet një shkëmbim cilësor dhe efikas i informatave para kthimit të fëmijës.

### **Parimet për mbrojtjen e viktimave të tregtisë me njerëz**

**Pëlqim i informuar** - e drejta e viktimës për informim të plotë dhe të saktë lidhur me integrimin dhe ndihmën, në mënyrë që të japë pëlqim për përkrahjen e planifikuar;

**Besueshmëri** - të dhënat e viktimës patjetër duhet të ruhen në kontekst të integrimin;

**Anonimitet** - të gjitha informatat ndahen vetëm në mënyrë anonime për të parandaluar si të tillë njohjen publike të viktimës së tregtisë me njerëz.

**Politika e privatësisë** - viktimat e tregtisë me njerëz kanë të drejtë të privatësisë dhe lirisë së mendimit dhe vendimmarrjes gjatë të gjitha fazave të integrimin;

**Mosdiskriminim** - ndaj personave që janë viktimat e tregtisë me njerëz nuk duhet të vepohet me vlerësim negativ të përvojës së tyre;

**Sigurimi dhe siguria** e viktimës është çështja më e rëndësishme gjatë integrimit dhe patjetër duhet të vlerësohet mirë;

**Ndjeshmëri** – raporti i respektimit dhe mirëkuptimit ndaj viktimës gjatë integrimit;

**Forcimi** - viktima e tregtisë me njerëz duhet të përvetësojë shkathësi dhe të ndihmohet të krijojë aftësi me të cilat do të forcohet dhe avancohet vetëbesimi i saj.

**Pjesëmarrja** - viktima e tregtisë me njerëz në mënyrë vullnetare merr pjesë në procesin e integrimit dhe në planin individual të integrimit dhe sipas mundësisë, në procesin e krijimit, zbatimit, përcjelljes dhe vlerësimit të shërbimeve, programeve dhe politikave të integrimit;

**Mbrojtja e të dhënave personale** - në pajtim me mekanizmat dhe standardet juridike nacionale dhe ndërkombëtare;

**Mbrojtja e fëmijëve dhe “interesi më të mirë të fëmijës”** – programet dhe politikat e integrimit duhet të sigurojnë mbrojtjen e fëmijëve nga tregtia me njerëz, ndërsa interesat e tyre më të mira të bëhen kujdes primar.

Respektimi i principeve etnike gjatë punës me viktima të tregtisë me njerëz është obligim i secilit njeri që është në kontakt me viktimën dhe fillimisht ka të bëjë me mënyrën e komunikimit me viktimën, ndjeshmërinë lidhur me nevojat e viktimës dhe respektimin e të drejtave njerëzore të saj.

# SESIONI V.

## BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET DHE ORGANIZATAT

*Elena, 26 vjeçe nga Kosova, vetë paraqitet në stacion policor, ku menjëherë i lëshohet një Aktvendim për strehim të përkohshëm të një të huaji dhe vendoset në QPH, me arsyetimin se ekzistojnë baza për dyshime se është viktimë e tregtisë me njerëz. Nga ana e nëpunësve policorë menjëherë është dërguar në IPSH Spitali i përgjithshëm, në repartin e akusherisë dhe gjinekologjisë për kontroll gjinekologjik, për shkak të përdhunimit të supozuar. Para dy muajve, Elena është sjellë ilegalisht nga Kosova në Shkup, Shkup, ndërsa më pas për 250 euro i është shitur një mashkulli për shërbime seksuale. Elena deklaroi se gjatë një muaji e gjysmë, pothuajse çdo ditë, mashkulli kishte pasur marrëdhënie seksuale me të kundër vullnetit të saj, ndërsa ndonjëherë kishte sjellë edhe miqtë e tij, të cilëve ajo është dashur t'u ofrojë shërbime seksuale. Gjithmonë kur kishte refuzuar marrëdhëniet me të, ishte keqtrajtuar fizikisht nga ai me grushta, duke e detyruar të mos rezistojë. Pas dy muaj e gjysmë, në orët e hershme të mëngjesit kishte arritur ta njoftojë policinë nëpërmjet telefonit celular, me ç'rast ishte marrë nga policia. Pas kontrollave të realizuara është vendosur në QPH për tri ditë e më pas është transferuar në Qendrën e viktimave të tregtisë me njerëz nga ana e Njësisë nacionale për luftimin e tregtisë me njerëz dhe migrimin ilegal.*

70

Identifikimi i viktimave të tregtisë me njerëz, mbrojtja e tyre dhe siguri mi i ndihmës dhe përkrahjes kërkon një bashkëpunim dhe koordinim të rregullt me organizatat dhe institucionet relevante të përfshira në parandalimin e tregtisë me njerëz në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Bashkëpunimi fillisht fokusohet në udhëzimin adekuat, sigurimin e shërbimeve, riintegrimin dhe risocializimin e viktimave të tregtisë me njerëz.

Ekzistojnë disa mekanizma dhe trupa që punojnë lidhur me çështjen e tregtisë me njerëz me mandate dhe nivele të ndryshme të veprimit, respektivisht Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale (MPPS), Ministria e Drejtësisë (MD), Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ), Ministria e Shëndetësisë (MSH), Ministria e Arsimit dhe e Shkencës (MASH), Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (PTHPNKOK).

Me qëllim të koordinimit dhe rritjes së efikasitetit gjatë veprimit, janë kr-



ijuar edhe një sërë mekanzimesh siç janë: Komisioni nacional për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe imigrim ilegal dhe trupat punuese në përbërje të saj, Sekretariati dhe Nëngrupi për luftë kundër tregtisë me njerëz, Mekanizmi Nacional për Udhëzime, Komisionet lokale për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe imigrimit ilegal, Njësia nacionale për luftimin e tregtisë me njerëz dhe kontrabandë të imigrantëve (NJLTNJMI<sup>23</sup>)/ Njësia për tregti me njerëz dhe kontrabandë të imigrantëve (NJTNJKM) Qendra e strehimit për të huajt pranë MPB-së, qendrat e përkohshme tranzistuese (Vinojug dhe Tabanoc) dhe Qendra për personat viktimë të tregtisë me njerëz dhe viktimë të dhunës seksuale.

## Komisioni nacional

Në mars të vitit 2001, Qeveria e Republikës së Maqedonisë solli Vendim për formimin e **Komisionit nacional për luftimin e tregtisë me njerëz dhe imigrimit ilegal të Republikës së Maqedonisë së Veriut**. Siç thekson edhe ueb-faqja e Komisionit, qëllimet e saj kryesore janë: 1) ndjekja dhe analizi i gjendjes së tregtisë me njerëz dhe migrimit ilegal, 2) koordinimi i aktiviteteve të institucioneve kompetente dhe 3) bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare të përfshira në zgjidhjen e problemeve nga sfera e tregtisë me njerëz. Komisioni ka përbërje ndërinstitucionale, ndërsa në të janë inkuadruar anëtarë nga Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Prokuroria Publike dhe Gjyqësori. Në vitin 2003, me qëllim të realizimit më të suksesshëm të aktiviteteve të Komisionit është formuar **Sekretariati i Komisionit** si dhe **Nëngrupi për luftimin e tregtisë me fëmijë**. Detyra e tyre kryesore është të zbatojë vendimet e Komisionit dhe në mënyrë aktive të koordinojë bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare, të cilat janë të inkuadruara në luftën kundër tregtisë me njerëz.

<sup>23</sup> Në seancën e 39-të të mbajtur më 17.11.2017. Është themeluar në bazë të vendimit të Qeverisë dhe memorandumit të bashkëpunimit të lidhur në mes të Prokurorisë Themelore Publike për Krim të Organizuar dhe Korrupsion (PTHPKOK) dhe MPB-së.

## Mekanizmi Nacional për Udhëzimin e viktimave të tregtisë me njerëz (MNU)

Baza e mekanizmave për luftën kundër tregtisë me njerëz është **Mekanizmi Nacional për Udhëzimin e viktimave të tregtisë me njerëz (MNU)** i cili është themeluar në vitin 2005 me përkrahjen e Misionit të OSBE-së në Shkup, e që punon me përkrahje të Ministrisë së Punës dhe të Politikës Sociale të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Mandati i Mekanizmit Nacional për Udhëzim është të sigurojë identifikim adekuat, ndihmë dhe mbrojtje, bazuar në standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe viktimave të tregtisë me njerëz, veçanërisht personave të mitur pa marrë parasysh nacionalitetin, përkatësinë etnike, moshën dhe gjininë. Në kuadër të Mekanizmit Nacional për Udhëzim funksionon edhe Zyra koordinuese në punën e së cilës marrin pjesë profesionistë nga 30 qendra për punë sociale dhe një përfaqësues nga Enti i Punëve Sociale. Gjatë procesit të udhëzimit dhe ndihmës së viktimave të tregtisë me njerëz është krijuar një bashkëpunim i ngushtë me përfaqësuesit e shoqatave të qytetarëve që janë aktivë në sferën në fjalë, si dhe palë të tjera të interesuara.

72

## Qendrat për Punë Sociale

Sistemi për mbrojtje sociale luan rol kyç në përkrahjen e viktimave, veçanërisht fëmijëve. Qendra për Punë Sociale ka mandat dhe obligim të sjellë vendime në interes më të mirë të fëmijës dhe t'i zbatojë ato duke shfrytëzuar të gjitha resurset për përkrahje brenda komunitetit.

## Ekipe Mobile

Në mënyrë plotësuese, për ta përmirësuar identifikimin në nivel lokal, Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale ka formuar **ekipe mobile për identifikimin e kategorive të rrezikuara, përfshi edhe viktimat e tregtisë me njerëz**. Ekipe mobile janë formuar në pesë qytete (Shkup, Manastir, Gjevgjeli, Tetovë dhe Kumanovë), ndërsa janë të përbërë nga anëtarët e NJNPKTNJ, punëtorët socialë dhe përfaqësues të sektorit joqeveritar. Është paraparë që ata në mënyrë proaktive të veprojnë në terren në disa komuna, të inkuadrohen në procesin e identifikimit të drejtpërdrejtë, të jenë kontakti i parë me kategoritë e rrezikuara dhe me viktimat e tregtisë

me njerëz, t'i udhëzojnë viktimat drejt institucioneve relevante, të bëjnë konstatimin e identitetit dhe vlerësimin e hershëm të rrezikut, të japin informata lidhur me ndihmën, të ofrojnë ndihmë juridike, etj.

## Ministria e Punëve të Brendshme

Policia është partneri kyç në identifikimin e viktimave dhe bashkëpunëtor aktiv për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, e cila i zbaton procedurat e identifikimit, vepron sipas urdhërësës së prokurorit dhe bën sigurimin e viktimës. Në kuadër të policisë ekzistojnë njësi organizative për **parandalim** të tregtisë me njerëz në **sektorët e punëve të brendshme (SPB)**. **Gjatë veprimit nga ana e policisë shfrytëzohen dhe respektohen procedurat dhe rregullat e parapara me ligjet dhe me PSO interne.**

## Njësia nacionale për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe migrameve ilegale (NJLTNJMI)

Në vitin 2018, me qëllim të përmirësimit të kapaciteteve të institucioneve për menaxhimin e dukurisë së tregtisë me njerëz, ishte formuar Njësia nacionale për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe migrameve ilegale (NJLTNJMI). Me këtë njësi udhëheq prokurori publik i Prokurorisë Themelore Publike për përndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Në përbërje të saj janë 32 anëtarë të përhershëm, prej të cilëve 16 në nivel qendror dhe 12 inspektorë, si dhe 16 në nivel lokal, nga dy prej çdo SPB dhe 21 persona kontaktues, të cilët organizohen sipas nevojës në rast se duhet të ushtrohen kompetencat policore, të cilat nuk duhet të dihet se burojnë nga njësia në formë të detyrave.

## Prokuroria Publike dhe Gjykata

Realizon përndjekjen penale dhe dënimin e kryerësve, shqipton masa mbrojtëse për viktimën, dhe vendos për kompensimin e dëmit. Prokuroria Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit siguron ndihmë dhe përkrahje për viktimat nëpërmjet ofrimit të këshillimeve dhe përfaqësimit të tyre nga ana e një të autorizuari falas, si dhe nëpërmjet sigurimit të mbrojtjes procedurale të viktimave gjatë tërë procedurës.

Gjykatat me aktgjykimet e fajësisë vendosin edhe për kërkesën e viktimës për kompensim të dëmit, në rastet kur viktima personalisht ose nëpërmjet të autorizuarit ka paraqitur kërkesa pronësore-juridike gjatë procedurës penale.

## Institucionet e mbrojtjes sociale dhe qëndrimit të përkohshëm –

Institucionet e mbrojtjes sociale dhe qëndrimit të përkohshëm ofrojnë dhe sigurojnë shërbime dhe programe për përkrahje, ofrojnë akomodim dhe ushqim, ofrojnë mundësi për inkuadrim social dhe lloje të tjera të përkrahjes së nevojshme për viktimën, veçanërisht nëse bëhet fjalë për fëmijë.

## Qendra për viktimat e tregtisë me njerëz dhe viktimat e dhunës seksuale

74

Viktimat potenciale të tregtisë me njerëz strehohen në Qendrën për viktime tregtisë me njerëz dhe viktimat e dhunës seksuale. Objekt ky në të cilin sigurohet akomodimi i përkohshëm i viktimave të tregtisë me njerëz dhe të huaj, me leje për qëndrim të përkohshëm ku përbushen nevojat e tyre themelore, sigurohet ndihma dhe përkrahja psikosociale e viktimave potenciale dhe/ose viktimave të tregtisë me njerëz dhe dhunës seksuale, me qëllim të integritetit të tyre të suksesshëm në shoqëri. Hapësira është e adaptuar dhe shfrytëzohet si zëvendësim i shtëpisë familjare. Kapaciteti i përgjithshëm i akomodimit është për 7 persona. Sigurohet punë 24 orë me ndrrime, nga ana e personave profesional.

## Qendra e strehimit për të huajt

Qendra e strehimit për të huajt është në pronësi të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa menaxhohet nga Ministria e Punëve të Brendshme, Sektori për çështje kufitare dhe migrim. Aty akomodohen shtetasit e huaj (të identifikuar dhe të supozuar) viktima të tregtisë me njerëz dhe imigrantë ilegalë, të zbuluar në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me vendqëndrim të parregulluar në shtet. I njëjti ka sigurim fizik policor gjatë 24 orëve, si dhe sistem të video monitorimit.

## Ministria e Arsimit dhe e Shkencës

Obligimet themelore të institucioneve arsimore dhe shkollave janë në sferën e parandalimit, zbulimit dhe udhëzimit të viktimave potenciale të tregtisë me njerëz. Kanë rol edhe gjatë identifikimit preliminar të nxënësve që janë viktimat potenciale të tregtisë me njerëz. Bashkëpunojnë me institucionet dhe organet kompetente për identifikimin dhe përkrahjen e viktimave të tregtisë me njerëz, siç janë Qendra për Punë Sociale dhe policia. Gjithashtu, mundëson sigurimin e përkrahjes së fëmijëve viktimat në shkollë, inkuadrimin e tyre në procesin arsimor, nëse e kanë ndërprerë shkollimin, si dhe përkrahë integrimin e tyre në sistemin arsimor.

## Inspektorati i Punës

Realizon mbikëqyrje inspektuese ndaj zbatimit të ligjeve dhe rregullave të tjera për marrëdhëniet e punës, punësimin dhe mbrojtjen gjatë punës, marrëveshjeve kolektive, kontratave të punës dhe akteve të tjera me të cilat rregullohen dhe realizohen të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e punëtorëve dhe punëdhënësve në sferën e marrëdhënieve të punës, punësimit dhe mbrojtjes gjatë punës.

## Organizatat joqeveritare

Marrin pjesë në identifikimin, sigurimin e përkrahjes dhe në përgjithësi luftojnë për mbrojtjen e të drejtave njerëzore të viktimës, si dhe për avancimin e Mekanizmit Nacional të Udhëzimit.

## Organizatat ndërkombëtare

Varësisht nga fushëveprimi i tyre: kryejnë kontrollin e punës së shtetit në aspekt të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe përndjekjen e kryerësve, ofrojnë përkrahje, edukim.

## Profesionistë dhe bashkëpunëtorë të tjerë

Psikoterapeutistë, avokatë, ndihmës, vullnetarë dhe të tjerët që ofrojnë lloje specifike ose të përgjithshme të përkrahjes në kuadër të koordinimit të përkrahjes së viktimës.

## Raportuesi nacional për tregtinë me njerëz

Është përcaktuar një Raportues nacional i pavarur për tregtinë me njerëz, ose funksion ekuivalent dhe një person është emëruar në atë funksion në vitin 2019. Raportuesi është përgjegjës për monitorimin e aktiviteteve të përgjithshme për luftën kundër tregtisë me njerëz dhe migrimin, mbledhjen dhe analizimin e të dhënave nga partnerët relevantë, miratimin e konkluzioneve dhe ofrimin e rekomandimeve për përmirësimin dhe përsosjen e luftës kundër tregtisë me njerëz dhe migrimit ilegal me qëllim të zbatimit të politikave për përgjigje më të mirë institucionale dhe rekomandime për qëllimet strategjike dhe përpunimin e raportit vjetor. Më konkretisht detyrat e punës së Raportuesit janë: mbledhja dhe analizi i të dhënave, informatave kualitative dhe kuantitative nga partnerët relevantë, kryerjen e monitorimit dhe vlerësimin të aktiviteteve të implementuara sipas Planit Nacional të Veprimit, pjesëmarrje në punën e Komisionit Nacional për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe migrimit ilegal, miratimin e konkluzioneve dhe dhënien e rekomandimeve që kanë të bëjnë me përmirësimin dhe përsosjen e përpjekjeve gjatë luftës kundër tregtisë me njerëz dhe migrimit ilegal në aspekt të implementimit të ligjeve, politikave për përgjigje më të mirë institucionale dhe rekomandimet për revizionin e qëllimeve strategjike, iniciimin dhe propozimin e qëndrimeve lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me luftimin kundër tregtisë me njerëz dhe migrimit ilegal, komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet dhe organizatat e inkuadruara në luftën kundër tregtisë me njerëz dhe migrimin ilegal, si dhe përpilimin e raportit vjetor.

# Aneksi 1.<sup>24</sup>

## VLERËSIMI I NEVOJAVE TË VIKTIMËS

<sup>24</sup> Faq. 40, PSO për procedimin me viktimat e tregtisë me njerëz, 2018

## KRITERIUME PËR VLERËSIMIN E NEVOJAVE

### I. TË DHËNA PËR RASTIN

1. Emri dhe mbiemri si dhe numri i dosjes për rastin

2. Vendi i prejardhjes

3. Gjuha

### NEVOJA ELEMENTARE

1. Akomodimi

2. Ushqimi

3. Ilaçe

4. Komunikimi me familjen

### II. VLERËSIMI I RREZIKUT

1. Kujdesi momental për sigurinë personale

2. Individë të cilat mund ti krijojnë probleme personit

3. Shqetësim për anëtarë të familjes ose njerëz të afërt

4. Vendet të cilat nuk janë të sigurta që personi të shkojë ose ti vizitojë

5. A është i ndjekur personi në ndonje kohë të caktuar në cilën kohë/dhe nga kush?

### III. NEVOJAT SHËNDETËSORE

1. Kontroll i detyrueshëm shëndetësor

### IV. KONTROLLE SIPAS NEVOJËS:

Kontroll i mjeksësisë ligjore

Grupi i gjakut, kontrolle mikrobiologjike

Sëmundje ngjitëse

Kontroll gjinekologjik

Shërbime stomatologjike

Probleme psikologjike dhe psikike

Gjendje të rrezikut të lartë (sëmundje kardiovaskulare, epilepsi, astmë)

Pengesa gjatë zhvillimit



# Aneksi 2.

## PLANI INDIVIDUAL për shfrytëzuesin, viktimë e tregtisë me njerë

**PLANI INDIVIDUAL për shfrytëzuesin, viktimë e tregtisë me njerëz**

**I. PLANI I TRAJTIMIT**

1. Emri dhe Mbiemri

2. Numri amëz

a) adresa e vendbanimit të përhershëm:

b) vendqëndrimi momental:

**3. LLOJI I SHFRYTËZUESIT**

3.1 Lloji i shfrytëzuesit

3.2 Ekspozimi ndaj rrezikut social

**4. NEVOJA PËR TRAJTIM**

5. Shëno potencialet:

E personit:

E familjes:

E komunitetit lokal:

6. Qëllimi i trajtimit:

7. Nevoja për intervenim në QV

**II NEVOJA PËR TRAJTIM**

1. Obligimet e ekipit profesional

Punëtori social:

Psikologu:

Pedagogu:

2. Obligimet e shfrytëzuesit:

3. Obligimet e institucioneve të tjera: QPS, MPB, MNU

Realizimi i planit dhe programit të trajtimit:

Shfrytëzuesi:

Personat profesional të Qendrës:

Personat profesional të IPQNPS Shkup:



